



Salla: Standard i ri
dinjiteti në zonat
rurale me hapjen
e negociatave
për bujqësinë

Faqe 7



FED invest përmbyll
një muaj të ngarkuar
me aktivitete
kombëtare
e ndërkombëtare

Faqe 2



Startup-et
agro-ushqimore,
motor i inovacionit
në bujqësinë
shqiptare

Faqe 6



AGROBIZNESI

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

15-ditëshi i dytë i muajit nëntor 2025

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 522
Çmimi 125 lekë

E përdryjavshme e pavarur

BAM TË SIGURTA, PAKETIM INTELIGJENT, EKSPORT I QËNDRUESHËM REKOMANDIME PRAKTIKE PËR KONTROLLE CILËSIE DHE GJURMUESHMËRI SIPAS STANDARDEVE TË BE-SË

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare



**Më shumë fonde për
bujqësinë - Kreu i
Këshillit të Agrobiznesit:
Sektori mbetet jetik,
duhet modernizuar**



Faqe 2

BOTIME

**Një libër i Prof. Dr. Tatjana
Dishnica dhe mesazhet
me vlerë që ai jep**



Faqe 12



**Gjurmë të punës së Agronomit
Gjergji Qafko në Shqipëri dhe Kanada**

Faqe 10

TEMA TË DITËS

- Kuvendi miraton në parim buxhetin 8.8 mld euro dhe paketën fiskale, opozita kundër Fq.2
- Rikthimi i kompensimit të TVSH në bujqësi çorodit fermerët; Si do funksionojë skema Fq.6
- Të vetëpunësuarit në bujqësi marrin online vërtetimin e pagesës së kontributeve përmes e-Albania Fq.6
- UBT feston 74-vjetorin, Sallaku: Shkenca dhe inovacioni, baza e bujqësisë së të ardhmes Fq.7
- Kalendari bujqësor, muaji dhjetor 2025 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

FINANCIM

**Buxheti 2026 për
bujqësinë dhe për
zhvillimin rural**

Faqe 4

Gëzuar 28 - 29 Nëntorin!



Më shumë fonde për bujqësinë - Kreu i Këshillit të Agrobiznesit: Sektori mbetet jetik, duhet modernizuar

Buxheti i vitit 2026 parashikon rritje të fondeve për sektorin e bujqësisë, me rreth 16.5 miliardë lekë të vëna në dispozicion për zhvillimin e këtij sektori, i cili pavarësisht sfidave mbetet jetik për ekonominë e vendit.

Kryetari i Këshillit të Agrobiznesit, Agim Rrapaj, i ftuar në "Sheshi i Dollarit", u shpreh se mbështetja financiare për bujqësinë është rritur vit pas viti, por sërish mbetet e pamjaftueshme krahasuar me nevojat reale dhe me vendet e rajonit.

Ai thekson se Shqipëria duhet të rrisë konkurrencën me vendet e rajonit.

Më tej, Rrapaj theksoi se bujqësia duhet trajtuar si një

sektor jetik dhe strategjik, duke shtuar se objektivi kryesor mbetet arritja e 1 miliard eurove eksporte.

Ai nënvizoi se zhvillimi i mëtejshëm kërkon nxitjen e kooperimit mes fermerëve, forma të reja organizimi, si dhe orientimin e të rinjve drejt bujqësisë.

"Po ashtu, ai bëri thirrje për më shumë investime në mekanizim, inovacion, digjitalizim, si dhe rritjen e efektivitetit në disbursimin e fondeve dhe granteve, të cilat janë kyçe për modernizimin e sektorit.

Buxheti për bujqësinë është rritur nga viti në vit. Buxheti është i pamjaftueshëm duke pasur parasysh shkallën e disbursimit që kemi. Rajoni në totalin

e shpenzimeve për bujqësinë, ndan një përqindje prej 3.5 % të buxhetit, kurse ne shkojmë pak më shumë se 1 %.

Kemi të bëjmë me një sektor, që është një sektor jetik. Jemi të detyruar që këtë biznes ta shikojmë nga pikëpamja jetike. Buxheti duhet të rritet për të qenë konkurrent me rajonin. Synimi mbetet arritja e një miliardë euro eksporte. Duhet të përqendrohemi te kooperimi.

Duhet parë si grupi, me disa forma të reja të organizimit. Duhet masa nxitëse për të orientuar të rinjtë në bujqësi. Duhet mekanizimi, inovacioni dhe digjitalizimi. Duhet financimi dhe disbursimi i fondeve grant", tha ai.

FED invest përmbyll një muaj të ngarkuar me aktivitete kombëtare e ndërkombëtare

Nëntori shënon pjesëmarrje në forume të nivelit të lartë, festimin e 33 viteve të historisë dhe prezantimin e vizionit të ri të ndikimit social në rajon

Nëntori ka qenë një muaj i rëndësishëm për FED invest, i cili ka shfaqur më fort se kurrë rolin e tij si institucioni më i madh i financës sociale në Shqipëri dhe si partner i besueshëm për zhvillimin ekonomik të komuniteteve të ndryshme urban dhe rural. Me një sërë aktiviteteve institucionale ka demonstruar qartë se vizioni i tij nuk kufizohet vetëm te ofrimi i shërbimeve financiare, por shtrihet drejt forcimit të kapaciteteve të bizneseve, rritjes së cilësisë dhe krijimit të ndikimit të qëndrueshëm në vend.

Forumi Kombëtar i Cilësisë & Kongresi i KASH (UNIDO – SECO), FED invest në mbështetje të sipërmarrjeve për standardizim dhe rritje

Një nga ngjarjet më të rëndësishme të muajit ka qenë pjesëmarrja e FED invest në Forumin e 3-të Kombëtar të Cilësisë dhe Standardeve, si dhe në Kongresin e 5-të të KASH, aktivitet i organizuar nga UNIDO dhe SECO. Ky forum mbledhi së bashku aktorë publikë dhe privatë, përfaqësues nga sektori industrial, ekspertë të tregtisë, sipërmarrës dhe institucione financiare që ndajnë një objektivi të përbashkët: rritjen e përputhshmërisë me standardet e Bashkimit Europian dhe rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimit vendas.

Në këtë aktivitet, Administratori i FED invest, Perlat Sulaj, ishte një nga folësit kryesorë në panelin kushtuar mbështetjes së sipërmarrjeve në orientimin drejt tregut evropian. Ai theksoi se bizneset shqiptare, veçanërisht ato të sektorit agroushqimor dhe agro-përpunimit, kanë nevojë për një kombinim të dy elementëve: financim të favorshëm dhe shërbime jo-financiare që i ndihmojnë të rriten me cilësi. Z. Sulaj solli në vëmendje rolin e rëndësishëm që FED invest ka luajtur vitet e fundit në këtë drejtim, përmes qasjes së zgjeruar në financim dhe forcimit të kapaciteteve të bizneseve në bashkëpunim me institucione publike dhe partnerë ndërkombëtarë. Ai veçoi gjithashtu kontributin e Qendrës ABA, e cila ka mbështetur dhjetëra biznese duke i ofruar asistencë teknike, njohuri mbi praktikën më të mirë duke demonstruar proceset, digjitalizimit dhe ofrimin e trajnimeve online dhe fizike. www.abaonline.al

Duke qenë se cilësia është

kusht për hyrjen në tregjet e BE-së, por edhe një faktor kyç për rritjen e qëndrueshme të bizneseve të vogla dhe të mesme, FED invest ka theksuar sërish gatishmërinë për të luajtur një rol aktiv në transformimin e sipërmarrjeve lokale. Ky angazhim, i mbështetur nga bashkëpunime të reja dhe partneritete strategjike, konfirmon pozicionimin e institucionit si një ndër aktorët më të rëndësishëm në zinxhirin e zhvillimit rural dhe ekonomik.

33 vite besim, solidaritet dhe ndikim social në komunitet

Nëntori përkoj edhe me një tjetër moment të rëndësishëm: shënimin e 33-vjetorit të kredisë së parë e cila është dhënë Gjinar të Elbasanit, më 10 nëntor 1992 duke shkruar fletët e para të librit të madh të historisë sonë që sot është simbol i suksesit. Pas 33 vitesh pune të palodhur dhe sakrificash, SHKK FED invest është shndërruar

me standarde dhe dinjitet.

Nga vizioni në impakt: Filozofia e FED invest për mikrofinancën moderne

Në vijim të këtij muaji të ngarkuar me dinamika, FED invest u përfaqësua gjithashtu në Konferencën Ndërkombëtare "MICROBALKANS25", një prej eventeve më të rëndësishme rajonale në fushën e mikrofinancës. Në këtë aktivitet, Perlat Sulaj mbajti një fjalë mbi temën "Nga vizioni, në impact", ku theksoi se mikrofinanca nuk është thjesht një instrument për t'i dhënë hua individëve apo bizneseve të vogla, por një mekanizëm i cili prodhon ndikim real, afatgjatë dhe me vlerë sociale. Ai solli shembuj konkretë të mënyrës se si FED investka ndihmuar komunitetet të zhvillohen jo vetëm ekonomikisht, por edhe në aspektin e fuqizimit social dhe profesional.



Kuvendi miraton në parim buxhetin 8.8 mld euro dhe paketën fiskale, opozita kundër

Kuvendi ka miratuar në parim projektbuxhetin 2026, me një vlerë totale prej 8.8 miliardë euro, në një seancë maratonë që zgjati rreth 16 orë dhe përfundoi rreth orës 03:00 të mëngjesit.

Dokumenti mori 83 votat pro të mazhorancës socialiste, ndërsa opozita votoi e gjitha kundër. Në sallë ishin të pranishëm 112 deputetë, nga të cilët 32 të opozitës u shprehën kundër.

Pas miratimit në parim, projektbuxheti dhe paketa fiskale do t'i rikthehen komisioneve dhe procedurës parlamentare për shqyrtim nen për nen dhe votim në tërësi.

Buxheti prej 8.8 miliardë eurosh parashikohet të mbështesë shërbimet publike dhe programet kryesore të qeverisë, nga shëndetësia, pagat, skemat e ndihmës për familjet në nevojë, pensionet dhe arsimi, te punësimi, bujqësia, transporti rrugor, drejtësia dhe fondet për sigurinë kombëtare, në kuadër të angazhimeve ndaj NATO-s.

Projektligjet e paketës fiskale 2026 sjellin disa ndryshime të rëndësishme për bizneset dhe qytetarët

Projektligji për fshirjen dhe shuarjen e detyrimeve tatimore parashikon faljen e rreth 500 milionë eurove detyrime e gjoba të papaguara deri më 31 dhjetor 2014, si dhe lehtësime për borxhet e krijuara gjatë viteve 2015–2024, me kusht që një pjesë të paguhet brenda vitit 2026.

Marrëveshja e re e paqes fiskale u jep bizneseve me xhiro mbi 14 milionë lekë mundësinë të negociojnë fitimin e tatueshëm për një periudhë deri në tre vjet. Fitimit të deklaruar i shtohet një marzh 18% që tatohet me 15%, ndërsa çdo fitim mbi këtë prag tatohet me 5%, duke krijuar lehtësi për bizneset e mëdha.

Projektligji për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme u mundëson qytetarëve dhe

kompanive të përafrojnë vlerën e pronës me çmimin real të tregut, kundrejt një tatimi vetëm 5%, duke ulur ndjeshëm kostot e tatimit mbi fitimin nga shitja.

Në ligjin e TVSH-së rikthehet kompensimi për bujqësinë, ku fermerët do të marrin 10% të vlerës së faturës nga grumbulluesit.

Ndryshimet në ligjin për procedurat tatimore ulin kufirin e pagesave me cash mes bizneseve nga 150 mijë në 100 mijë lekë dhe vendosin kufi maksimal 500 mijë lekë për pagesat cash nga individët dhe të vetëpunësuarit.

Projektligji për sistemin e taksave vendorepërfashton nga taksa e ndikimit në infrastrukturë investimet publike në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale.

Dy nismat e tjera, për faturën dhe monitorimin e qarkullimit si dhe ndryshimet në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat", sjellin lehtësime për sponsorizimet në sport, kërkim dhe zhvillim.



në kooperativën financiare më të madhe në vend, e pranishme në çdo zonë të Shqipërisë dhe në shërbim të mbi 3,000 fshatrave përmes një rrjeti prej 54 degësh. Tre dekada më vonë, FED invest vazhdon të mbetet i përkushtuar ndaj vlerave që e kanë shoqëruar që nga dita e parë: besimi, solidariteti dhe përkushtimi ndaj anëtarëve.

Përvjetori është shfrytëzuar jo vetëm për të reflektuar mbi të shkuarën, por edhe për të ripërtërirë misionin për të ardhmen. Sot, institucioni është shndërruar në një rrjet të gjerë shërbimesh financiare e jofinanciare që mbështesin individët, familjet dhe bizneset në çdo cep të vendit. Mesazhi që e ka shoqëruar këtë datë ka qenë i qartë: FED invest do të vazhdojë të punojë me të njëjtin përkushtim për të sjellë mundësi të reja, për të forcuar mirëqenien ekonomike të komuniteteve rurale dhe për t'i mundësuar bizneset të rriten

Në këtë konferencë u vu në dukje se vizioni i institucioneve financiare duhet të shoqërohet me angazhim konkret në terren dhe me rezultate të matshme që kontribuojnë në përmirësimin e jetesës së njerëzve. Kjo qasje është tashmë një pjesë e pandarë e strategjisë së FED invest, i cili synon të zgjerojë më tej ndikimin e tij pozitiv në vitet që vijnë.

Të tre aktivitetet e zhvilluara gjatë nëntorit – forumi kombëtar, konferenca ndërkombëtare dhe përvjetori i 33-të – formojnë një tablo të qartë të angazhimit të institucionit për të qenë një aktor serioz në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Kjo dëshmon se FED invest vazhdon të ndërtojë ura bashkëpunimi, të forcojë pozicionin e tij dhe të promovojë vlera që shkojnë përtej shërbimit financiar: cilësi, integritet, vizion dhe besim.

BAM TË SIGURTA, PAKETIM INTELIGJENT, EKSPORT I QËNDRUESHËM

REKOMANDIME PRAKTIKE PËR KONTROLLE CILËSIE DHE GJURMUESHMËRI SIPAS STANDARDEVE TË BE-SË

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

Përpunimi dhe tregtimi i bimëve mjekësore dhe aromatike (BAM) përfaqëson një nga sektorët më premtues të ekonomisë rurale në Shqipëri. Me një traditë të gjatë kultivimi dhe mbledhjeje, vendi ynë gëzon një reputacion të qëndrueshëm për cilësi, aromë dhe përbërje natyrore bioaktive. Megjithatë, konkurrenca globale dhe kërkesat gjithnjë e më të rrepta të Bashkimit Europian e bëjnë të domosdoshme që prodhuesit dhe përpunuesit shqiptarë të përshtatin praktika më të avancuara të kontrollit të cilësisë, gjurmueshmërisë dhe sigurisë së produktit. Kalimi drejt një zinxhiri të standardizuar dhe të dokumentuar jo vetëm rrit besueshmërinë e sektorit, por krijon bazën për eksport të qëndrueshëm dhe çmime më të larta tregu.

Në këtë kontekst, artikulli paraqet disa rekomandime praktike mbi mënyrën se si operatorët e sektorit BAM—nga fermerët, grumbulluesit dhe pikat e përpunimit, deri te eksportuesit—mund të përmirësojnë proceset përmes standardeve të BE-së si GACP, HACCP, ISO 22000, Organik, si dhe kërkesave të gjurmueshmërisë së tregut evropian. Qasja e duhur nuk kërkon vetëm investime, por edhe disiplinë teknike, dokumentim të saktë dhe kulturë cilësie në çdo hallkë të zinxhirit.

Kodi i Praktikave të Mira Bujqësore dhe të Mbledhjes (GACP): Hapi i parë drejt cilësisë

Standardet e GACP janë themeli mbi të cilin ndërtohet cilësia e BAM-ve që nga ferma. Ato kërkojnë identifikim të saktë botanikal të bimëve, menaxhim të kontrolluar të tokës, ujitjes dhe plehërimit, si dhe përdorim të metodave të sigurta të mbledhjes. Për fermerët dhe mbledhësit shqiptarë, zbatimi i GACP nënkupton adoptimin e praktikave të unifikuara si regjistrat e parcelave, evidentimi i datave të mbjelljes, mbledhjes dhe tharjes, si dhe monitorimi i kushteve më kritike si lagështia dhe temperatura gjatë tharjes. Përtej nevojës së tregut, këto praktika përmirësojnë qëndrueshmërinë e prodhimit, ulin humbjet pas-korjes dhe sigurojnë që çdo lot produkti të jetë i parashikueshëm dhe i kontrolluar.

Një sfidë e shpeshtë në terren është përzjerja e llojeve, kontaminimi me trupëza të huaja ose mosrespektimi i moshës së duhur të mbledhjes. Këto ndikojnë drejtpërdrejt në përbërjen kimike dhe vlerën e eksportit. Prandaj, formimi i kapaciteteve të grumbulluesve dhe puna me kooperativa apo GVV-e bëhet thelbësore për të mbajtur të njëjtin standard në zona të gjera prodhimi. GACP nuk është një dokument, por një kulturë e cila duhet të ndiqet në çdo hap.

Kontrollet laboratorike: garancia e sigurisë dhe standardizimit

Bashkimi Europian kërkon që produktet e sektorit BAM të jenë të sigurta për konsumatorin dhe të mos përmbajnë metale të rënda, pesticide, mikotoksina apo mikroorganizma të dëmshme. Për këtë arsye, analizat laboratorike të akredituara janë një detyrim për çdo lot të destinuar për

eksport.

Rekomandohet që eksportuesit të vendosin protokolle të rregullta testimi për parametrat kryesorë: pH, lagështi, vajra esenciale, përbërje aktive, pesticide dhe kontaminime mikrobiale. Këto analiza duhet të ruhen dhe të jenë të aksesueshme për inspektimet e BE-së dhe klientët ndërkombëtarë. Përdorimi i laboratorëve të akredituar sipas ISO/IEC 17025 rrit besueshmërinë e certifikatave dhe shmang refuzimin e mallrave në doganat e BE-së.

Një praktikë e rëndësishme është marrja e mostrave për përfaqësim të plotë. Shpesh, eksportuesit hasin probleme kur mostra e analizuar nuk përfaqëson saktë të gjithë lotin, çka çon në mospërputhje cilësie. Standardet evropiane kërkojnë procedura të qarta të marrjes së mostrave, përzierjes dhe ruajtjes së tyre deri në momentin e dorëzimit në laborator.

Paketimi i mençur: mbrojtje, ruajtje dhe marketing

Paketimi nuk është vetëm një mbështjellës; është një element kritik i cilësisë dhe një instrument marketingu që komunikon profesionalizëm dhe përputhshmëri me standardet ndërkombëtare. Për BAM-të, paketimi duhet të sigurojë mbrojtje nga drita, oksigjeni dhe lagështia, të jetë i përshtatshëm për natyrën higroskopike të bimëve, dhe të ruajë aromën dhe përbërjen aktive deri në destinacion.

Materialet e rekomanduara përfshijnë qeset me shumë shtresa të aprovuara për kontakt me ushqimin, kuti kartoni të fortifikuara dhe thasë me fibra natyrore të personalizuar. Gjithashtu, etiketimi sipas kërkesave të BE-së duhet të përfshijë: emrin botanikal, numrin e lotit, origjinën, datën e prodhimit, kushtet e ruajtjes dhe certifikimet (Organik, GACP, HACCP).

Në vitet e fundit, paketimi inteligjent po bëhet trend: përdorimi i sensorëve për monitorimin e lagështisë, QR-kodet për gjurmueshmëri dhe etiketat anti-manipulim rrisin nivelin e sigurisë dhe transparencës për konsumatorët. Për eksportuesit shqiptarë, adoptimi i këtyre teknologjive do të ishte një avantazh konkurrues i rëndësishëm.

Gjurmueshmëria: çelësi i besimit dhe hyrjes në treg

Sipas rregulloreve të BE-së, çdo produkt duhet të jetë i gjurmueshëm nga ferma deri te konsumatori. Kjo kërkon një sistem të qartë dokumentimi dhe evidentimi në të gjitha hallkat e zinxhirit. Gjurmueshmëria nuk është vetëm një detyrim, por edhe një mjet strategjik për të menaxhuar rrezikun dhe për t'i dhënë klientëve ndërkombëtarë garanci mbi origjinën dhe cilësinë e produktit.

Një sistem tipik i gjurmueshmërisë për BAM duhet të përfshijë: kodimin e lotit, regjistrimin e furnitorëve, dokumentimin e proceseve të tharjes, pastrimit, grirjes dhe paketimit, si dhe vegla digjitale që lehtësojnë ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave. Përdorimi i platformave ERP, aplikacioneve

mobile dhe databazave të centralizuara e bën më të lehtë menaxhimin e informacionit dhe përmbushjen e kërkesave inspektuese të BE-së.

Në praktikën më të avancuara, gjurmueshmëria mbështetet në teknologji të tilla si blockchain, të cilat sigurojnë transparencë të plotë dhe eliminim të manipulimeve të të dhënave. Ndërmarrjet shqiptare që synojnë tregun premium mund të eksplorojnë këto modele për t'u diferencuar nga konkurrenca.

Sistemet e menaxhimit të cilësisë: rruga drejt qëndrueshmërisë së eksportit

Adoptimi i sistemeve të menaxhimit të cilësisë është një investim që shpërblen në afatgjatë. Standardet si ISO 22000, HACCP dhe GlobalG.A.P. jo vetëm rrisin sigurinë e produktit, por forcojnë besimin e partnerëve ndërkombëtarë dhe eliminojnë barrierat që mund të lindin në tregjet e BE-së.

Implementimi i këtyre sistemeve duhet parë si proces i vazhdueshëm, ku kompania identifikon rreziqet kryesore, harton procedura për kontrollin e tyre dhe trajnon stafin në mënyrë të vazhdueshme. Një ndër aspektet më të rëndësishme është auditimi i brendshëm, i cili ndihmon ndërmarrjen të identifikojë pikat e dobëta përpara se ato të shfaqen si problem tek klientët.

Ndërmarrjet shqiptare që kanë investuar në këto sisteme raportojnë rritje të stabilitetit të prodhimit, përmirësim të marrëdhënieve me blerësit dhe rritje të çmimit për njësi. Standardet nuk janë thjesht një kusht formal; ato krijojnë rend, disiplinë dhe profesionalizëm në menaxhimin e biznesit.

Përfundim: cilësia dhe inovacioni, baza e konkurrueshmërisë së sektorit BAM

Për të ndërtuar një sektor të fortë, të qëndrueshëm dhe të aftë për të konkurruar në tregjet ndërkombëtare, Shqipëria duhet të përqendrohet në cilësinë, sigurinë dhe gjurmueshmërinë e produkteve të saj. BAM-të tona kanë potencial të madh natyror, por ky potencial nuk shfrytëzohet plotësisht pa investim në standarde, laboratorë, digjitalizim dhe paketim modern.

Rritja e kërkesave të BE-së duhet parë si mundësi, jo si pengesë. Ato na nxisin të përmirësohemi, të inovojmë dhe të ndërtojmë produkte me vlerë të lartë të shtuar. Përmes bashkëpunimit mes fermerëve, grumbulluesve, laboratorëve, institucioneve dhe ndërmarrjeve eksportuese, Shqipëria mund të pozicionohet si një qendër e rëndësishme e prodhimit të BAM-ve cilësore në Ballkan dhe Europë.

Shndërrimi i sektorit ndodh hap pas hapi: BAM të sigurta, paketim i mençur, dhe mbi të gjitha - eksport i qëndrueshëm.

Kjo është formula e suksesit për të ardhmen e sektorit tonë.



Buxheti 2026 për bujqësinë dhe për zhvillimin rural

Ministri Salla paraqet në Kuvend buxhetin 2026 për bujqësinë: prioritet mbështetja e fermerëve dhe investimet

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural prezantoi në Komisionin e Ekonomisë projektbuxhetin 2026 për sektorin, duke dhënë një panoramë të zhvillimeve pozitive që po shënon bujqësia dhe fushat ku do të fokusohet financimi vitin e ardhshëm.

Ai theksoi se prioritet kryesor mbetet skema kombëtare e mbështetjes për fermerët, e

- Fjala e plotë e ministrit të Andis Salla -

Bujqësia shqiptare sot prodhon më shumë sesa në vitin 2013, produktet bujqësore janë rritur, perimet 57% më shumë, bimët aromatike e mjekësore janë rritur me 65%, pemët frutore me 1/3tën. E njëjta tendencë është edhe për ullinjtë dhe agrumet.

Eksportet agro-ushqimore kanë kaluar nga 14,6 miliardë lekë në vitin 2013 në 53,2 mld lekë në vitin 2024.

Për 9-mujorin e këtij viti eksportet kanë arritur 41,4 miliardë lekë ose 7,4% më shumë se 9 mujori i vitit i një viti më parë.

Raporti i mbulimit eksporte importe bujqësore është përmirësuar nga 6,4 lekë importe për 1 lek eksporte në vitin 2013 në 2,9 lekë sot.

Kjo është akoma më e rëndësishme po të konsiderojmë edhe rritjen e kërkesës së brendshme ushqimore që vjen nga turizmi.

Edhe pjesëmarrja në skemat e mbështetjes është zgjeruar: nga 11 mijë përfitues në vitin 2013 në më shumë se 71 mijë në vitin 2025, me një rritje të buxhetit me më shumë se 3,5 herë.

Sot mbështesim bujqësinë, blegtorinë, serat, bimët mjekësore dhe aromatike dhe investimet në zonat rurale.

Pra biem të gjithë dakord që bujqësia është në një fazë të re zhvillimi.

Ky zhvillim vjen nga më shumë sipërfaqe të ujitura, më shumë fonde investimi dhe më shumë qendra grumbullimi.

Ne duhet të ecim përpara për hapin e radhës atë të përgatitjes për anëtarësimin në BE, deri në vitin 2027.

Sektori ynë por edhe të gjithë aktorët fermerë, blegtorë, grumbullues, përpunues, tregtues etj., duhet që të kenë përgatitjen e nevojshme për të pasur një integrim sa më të frytshëm në familjen evropiane dhe tregun unik.

Sot paraqesim një buxhet që e vendos bujqësinë shqiptare në shinat e anëtarësimit.

Me hapjen e negociatave për Klasterin-in 5-të, Kapitujt 11, 12 dhe 13 në nëntor, çdo lek që planifikojmë shkon për të mbyllur hendekun me BE-në, jo vetëm për të shpenzuar, por për të dorëzuar standarde dhe për të hapur rrugën e financimeve pas-anëtarësimit në 2030.

Ky s’është thjesht buxhet, por është instrument negociatash.

Buxheti fokusohet në përmbushjen e angazhimeve të Kapitujve 11, 12 dhe 13, dhe përafrimin me KAP për ngritjen e sistemeve që kërkon Aki Komuniter. Çdo qindarkë që shpenzojmë duhet të përkthehet në kapacitete, standarde dhe gjurmueshmëri që na afrojnë me BE-në.

Për herë të parë e shoqërojmë buxhetin me masa fiskale në një qasje të vetme që krijon efekt të shumëfishtë në zinxhirin e vlerës, nga prodhimi, te grumbullimi e përpunimi. Kalohet nga subvencioni, te rezultati i matshëm në konkurrueshmëri, siguri ushqimore dhe eksport.

Ky është thelbi i qasjes sonë.

Skema e re e mbështetjes i mëson fermerët të prodhojnë sot me rregullat që do të gjejnë nesër në BE pra formalizim, faturim, gjurmueshmëri, standarde cilësie dhe sigurie ushqimore.

Kushti është i thjeshtë dhe i drejtë: sa herë që shet me faturë, aq herë ke akses në mbështetje.

Prandaj, përtej rritjes nominale, vlera e vërtetë e këtij buxheti qëndron te bashkëveprimi buxhet - ndërhyrje fiskale dhe te orientimi i tij drejt standardeve të BE-së.

Në këtë kuadër, draft Ligji i Projekt-buxheti të vitit 2026 për MBZHR është 16.3 miliard lekë, ose 11.3% ose 11 milion euro më shumë për fermerët, përpunuesit, peshkatarët shqiptarë. Ky është buxheti më i lartë që ka pasur ndonjëherë bujqësia shqiptare dhe është rreth 3 herë më shumë se sa në vitin 2012.

Më shumë buxhet do të kenë

- o Investimet e brendshme me fondet e buxhetit të shtetit me rreth 32%.
- o 14.5% më shumë për zhvillimin rural dhe skema kombëtare mbështetëse me 16%,
- o Rreth 80% në programin buxhetor të sigurisë ushqimore.

Katër do të jenë shtyllat mbi të cilat ndërtohet buxheti

- 1) Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë dhe zonave rurale
- 3) Siguria ushqimore
- 2) Zhvillimi i qëndrueshëm i peshkimit dhe ekonomisë blu.
- Dhe së fundi 4) Kapacitetet, bashkëpunimi, inovacioni dhe digjitalizimi.

Por nuk mund të lë pa përmendur tokën dhe ujin, si dy burime të cilat janë themelore për procesin e prodhimit bujqësor dhe blegtoral.

Do të vazhdojmë që të investojmë në ujitje-kullim dhe mbrojtje nga përmybtjet, duke rritur sigurinë për fermerët dhe duke ulur humbjet.

Në mënyrë më të detajuar

Programi i Zhvillimit Rural është boshti i kësaj pakete me 7.7 miliard lekë në 2026 ose 47,5%% të buxhetit total të MBZHR.

Me këtë program zbatojmë prioritetet 2025–2029 dhe e afrojmë sektorin me KAP deri në 2030,

Kjo do të thotë më shumë prodhim, më shumë cilësi, më shumë treg. Në qendër qëndron Skema Kombëtare e cila ndërtohet mbi rritjen e prodhimit dhe potencialeve të

shoqëruar nga skema e investimeve, si dhe fondet për ujitjen dhe kullimin, sigurinë ushqimore, peshkimin dhe zhvillimin digjital të sektorit.

Ministri deklaroi se buxheti 2026 synon rritjen e produktivitetit dhe forcimin e qëndrueshmërisë së bujqësisë shqiptare, duke e orientuar sektorin drejt standardeve të BE-së.

tregjeve.

5.2 miliard lekë shkojnë për pagesa direkte dhe grante investimi për ferma, për forcimin e zinxhirit të vlerës dhe agroturizmin. Kjo vlerë është 16% më shumë se buxheti fillestar i vitit 2025.

Thirrja e fundit për investime në ferma, linja përpunimi dhe agroturizëm pati më shumë se 800 aplikime të cilat do të vazhdojnë të zbatohen edhe në vitin 2026. Kështu kjo skemë do të injektojë në modernizimin e sektorit gjatë vitit në vijim së paku 2 miliard lekë, dhe investimet janë rritur me 27%.

Objektivi ynë është i qartë dhe i bërë publik në planin e qeverisë 2030:

Skemë me buxhet deri 100 milion € në vit, 150,000 përfitues dhe kushtëzime për praktika mjedisore, siguri ushqimore, gjurmueshmëri dhe mirëqenie kafshësh.

Këtë vit skema shoqërohet nga instrumenti fiskal që e çon rritjen e të ardhurave në çdo fermë, serë, pemtore, apo stallë blegtorale.

Kompensim 10% i TVSH-së së inputeve , i lidhur me shitjet me faturë për çdo fermer me NIPT fermeri.

Në praktikë 10% e vlerës së faturës së shitjes i kthehet fermerit si kompensim mbi vlerën e produktit të shitur.

Kjo ul kostot e prodhimit, forcon lidhjen prodhim–grumbullim–përpunim, rrit gjurmueshmërinë dhe sigurinë ushqimore për konsumatorin vendas dhe të huaj.

Vetëm kjo masë sipas të dhënave paraprake mbështet fermerët dhe bujqësinë me rreth 1.5 miliard lekë çdo vit.

Pra ndërtojmë një qasje të re për të gjithë fermerët nëpërmjet parimit: faturò dhe përfito.

Për të garantuar praktikisht procesin e anëtarësimit, investojmë në sistemet që kërkon AKIS. Kjo bën që në vitin 2026, ne të kemi një rritje në investime në nivelin 27%.

1.3 miliard lekë shkojnë për sistemin AJAKS dhe ELPIAJES (LPIS) kusht për akreditimin e Agjencisë së Pagesave, sisteme për Organizimin e Tregjeve, informacionin e çmimeve dhe FADN.

Ndërsa fondi 1.1 miliard lekë siguron ecurinë e projekteve sipas marrëveshjeve me donatorët.

Ne vazhdojmë të punojmë për të arritur objektivin tonë të shpallur tashmë atë të eksporteve të bujqësisë dhe peshkimit prej 1 miliard Dollarë deri në 2030.

Dua të theksoj se instrumentet të tjerë si fondi i garancisë ka hapur kredi të buta për prodhimin bujqësor dhe agrobiznesin, duke shumëzuar çdo lek publik me investim privat.

Garancia sovrane i mundëson aktorëve të sektori kredi me normë interesi 2% si pjesë e fondit të vënë në dispozicion prej 250 milion Euro nga Banka e Shqipërisë.

Kjo mbështetje me vlerë 3 miliard lekë do të rinovohet edhe për vitin 2026.

Programi i dytë buxhetor është ai i sigurisë ushqimore i cili ka një vlerë prej 2,9 miliard lekë për vitin 2026 ose një rritje prej 12,1%.

Kemi rritur me pothuaj 80% investimet e brendshme të cilat do të përkthehen në më shumë laborator, më shumë analiza të akredituara më shumë siguri ushqimore, me produkte më pranë BE,

Ky program synon garantimin e sigurisë ushqimore, shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe shëndetin e bimëve dhe njerëzve.

Kjo arrihet së pari duke përafruar plotësisht kuadrin tonë ligjor me atë të BE,

së dyti duke vendosur nën kontrollin zyrtar të gjithë territorin e vendit përmes inspektorateve të ri organizuara,

dhe së treti duke mësuar, edukuar dhe mbështetur të gjithë operatorët e zinxhirit ushqimor në përmbushjen e standardeve për të qenë të barabartë në tregun evropian.

Qëllimi politik është i qartë mbrojta e konsumatorit shqiptar me produkte ushqimore të sigurta, çmime të përballueshme dhe konkurruese me ato të importit si dhe nxitjen e prodhimeve për eksporte cilësore në vendet e BE dhe të rajonit .

Prioritetet tona për vitin 2026 janë:

Forcojmë laboratorin e Referencës Kombëtare (ISUV) dhe 7 laboratorët rajonalë të shëndetit të kafshëve, shëndetit të bimëve dhe sigurisë ushqimore .

Rrisim kapacitetet analitike zgjerojmë gamën e testeve të akredituara, sigurojmë mirëmbajtjen periodike të tyre.

Kjo e bën sistemin të besueshëm dhe rrit potencialin eksportues të produkteve bimore duke mundësuar edhe hapjen e tregjeve për produktet shtazore.

Rrisim gjurmueshmërinë e produkteve ushqimore brenda në fermë, që nga fara e fidani, trajtimi, ujitja, karenca e deri tek produkti ushqimor për treg të brendshëm apo eksport.

Rrisim gjurmueshmërinë në të gjithë zinxhirin e tregtimit të produktit sapo del nga ferma deri në tavolinë.

Buxheti 2026 për bujqësinë dhe për zhvillimin rural

(Vijon nga faqja 4)

Po kështu rrisim gjurmueshmërinë e ushqimeve shtazore që fillon me ushqimin për kafshë, kafshët, produktet dhe nën produkteve të tyre.

Qasja e përbashkët “Një shëndet” rrit bashkëpunimin me të gjithë faktorët e aktorët profesionistë, mjekë, farmacistë, veterinerë, agronomë, zooteknikë etj.

Në këtë kuadër jemi duke hartuar ligjin për urdhrin profesional të agronomit, ku roli i agronomit do të kthehet në aset për të rritur cilësinë e shërbimit që i ofrohet fermerëve. Agronomi do të ketë përgjegjësinë e përdorimit të Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve për të mundësuar një gjurmueshmëri të këtyre produkteve në çdo hallkë.

Po ndërtojmë për herë të parë një qasje në të cilën të njëjtat kushte kontrolli që zbatohen në zinxhirin e qarkullimit të barnave dhe funksionimin e farmacive humane, ta zbatojmë edhe tek farmacitë bujqësore duke ngritur një sistem kontrolli të digjitalizuar .

Nuk i lëmë asgjë rastësisë kur bëhet fjalë për shëndetin e njerëzve.

Pajisim veterinerët me komplete biologjike, laptopë dhe tableta për regjistrim elektronik, dhe certifikatën e lëvizjes së kafshëve.

Rrisim, kapacitetet me trajnim periodik mbi sëmundjet, për të cilat nevojiten masa të menjëhershme për kontrollin dhe çrrënjosjen e tyre, dhe biosigurinë.

Krijojmë një mekanizëm emergjent, me buxhet fleksibël, për ndërhyrje të menjëhershme kur kjo është e nevojshme.

Finalizojmë paketën ligjore që përbëhet nga Ligji “Për Produktet për Mbrojtjen e Bimëve”, Ligji “Për Kontroll-let Zyrtare”, Ligji “Për organizmat e modifikuara gjenetikisht”, për përafrim për materialin mbjellës, si dhe aktet nënligjore përkatëse.

Riorganizojmë shërbimin fitosanitar me sisteme elektronike dhe forcojmë Pikat e inspektimit kufitar duke filluar ndërtimin e 6 pikave të reja.

Forcojmë laboratorin e referencës duke përfshirë një laborator të ri për OMGJ.

Jemi duke hartuar Planin shumëvjeçar me bazë risku për shëndetin e bimëve, materialin mbjellës dhe Produktet e Mbrojtjes së Bimëve, në linjë me Rregulloren e BE.

Puna jonë do të përqendrohet edhe në ndërgjegjësimin dhe edukimin e fermerëve si edhe operatorëve të biznesit ushqimor për përbushjen e kushteve dhe standardeve e nevojshme për tregun BE-së.

Peshkimi për vitin 2026 do të financohët 10% më shumë,

Ky program vendos një kurs të qartë: peshkim dhe akuakulturë të qëndrueshme, me përdorim të përgjegjshëm të burimeve dhe përputhje të plotë me politikën e përbashkët të peshkimit të BE. Me këtë buxhet synojmë rritje të prodhimit me 10–20% dhe eksporte +60–70% deri në 2027, duke lidhur sektorin me standarde, gjurmueshmëri dhe tregjet.

Boshti i parë është tregu. Ndërtojmë tregje të reja dhe vëmë në funksion/ mirëmbajtje ato ekzistuese, që produktet peshkore të dalin më shumë, më cilësore, më të sigurta dhe të gjurmuara, konkurruese në tregun vendas dhe atë të BE-së.

Boshti i dytë është biologjia dhe furnizimi: modernizojmë qendrat e rasatit dhe rrisim prodhimin në ≈2 milion copa/vit, për të mbështetur ripopullimin e liqeneve natyrore, ruajtur biodiversitetin dhe garantuar zënie afatgjata për komunitetet.

Boshti i tretë është Butrinti: nisja në 2026 e thellimit të Kanalit të Vivarit rrit këmbimin ujë–det, stabilizon parametrat fiziko-kimikë dhe krijon kushte ideale për rritjen e midhjes, duke rritur sasinë dhe vlerën e produktit në një aktivitet tradicional me impakt social për zonën.

Infrastruktura portuale është leva e katërt: shtojmë kapacitetet ankoruese dhe shërbimet bazë (ujë i pijshëm, karburant), për efikasitet logjistik dhe kosto më të ulëta për operatorët.

Në të njëjtën kohë, propozojmë një skemë mbështetëse shtesë prej 400 mln lekë si politikë struktur-ore: modernizim i flotës, ulje e impaktit mjedisor, riparime, zëvendësim motorësh, investime në bord, si dhe mbështetje për akuakulturën (modernizim fermash peshku dhe molusqesh, organizata prodhuesish, diversifikim produkti). Skema do të ndjekë parimet e BE-së, për të përbushur Pozicionin Negociues të Kapitullit 13.

Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes (2026)

Programi i ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet mbetet një prej shtyllave të ndërhyrjes tonë.

Në vitin 2025 ne kemi pasur një ecuri shumë pozitive ku përtej ndërhyrjeve që ishin parashikuar në buxhetin fillestar ne kemi mundësuar me aktin normativ të qershorit që të rrisim investimet në këtë sektor.

Janë financuar 86 objekte me një vlerë investimesh prej 2.3 miliard lekë në objekte të ujitjes, në rehabilitim të hidrovorëve dhe dhe mbrojtje nga përmbytja.

Vazhdojmë në vitin 2026 të shndërrojmë investimin në ujitje dhe kullim në më shumë prodhime bujqësore.

Tavani buxhetor i parashikuar është mbi 3,6 miliardë lekë ose 26,4% më shumë sesa në vitin 2025.

Do të investojmë më shumë për të përmirësuar dhe modernizuar ujitjen dhe kullimin dhe për t’u mbrojtur më mirë nga faktorët natyrorë siç është përmbytja.

36% më shumë investime të brendshme do të ketë ky sektor në vitin 2026.

Do ta shpërndajmë këtë investim aty ku efekti në rendiment dhe uljen e kostove është më i lartë:

rreth 1.5 miliard lekë shkojnë për rehabilitimin e kanaleve ujitës nga të cilat rreth 70% shkojnë për mbështetjen e bashkive,

rreth 815 milion lekë për investimet në argjinaturat lumore, për rritjen e mbrojtjen nga përmbytjet dhe 250

milion lekë për rehabilitimin e hidrovoreve.

Si pasojë e rritjes se investimeve për vitin 2025 me aktit normativ të tetorit, aktualisht për vitin 2026 numri objekteve në të cilat vazhdojmë punën është 43 nga te cilët 22 i përkasin bashkive.

Kështu, në ujitje, përmirësojmë shërbimin në rreth 10,000 ha.

Në mbrojtjen nga përmbytjet, ndërtojmë dhe rehabilitojmë rreth 10 km argjinatura në lumenjtë Drin, Bunë, Kir, Mat, Shkumbin, Osum, Seman, Borsh, Shushicë.

Në kullim, përfundojmë rikonstrukcionin e hidrovorit të Orikumit duke përmirësuar kullimin në 500 ha dhe rehabilitojmë hidrovorin e qytetit të Vlorës për të shmangur përmbytjet urbane në reshje intensive.

Me 630 milionë lekë shpenzime operative, mirëmbajmë dhe përmirësojmë kullimin në mbi 60,000 ha përmes lëvizjes së më shumë se 2.5 milion m³ dhera. Garantojmë mirëmbajtjen dhe operimin 27 hidrovoreve në të gjithë vendin.

Investimet nga projektet e huaja mbeten një mundësi tjetër financimi.

Projekti i Bankës Botërore sjell një investim prej 26.1 milionë euro në ujitje dhe kullim.

Kryejmë fizibilitetin për rikthimin e ujitjes në 4,000 ha në Tërbuf

Në kullim investojmë 9.4 milionë euro që do të modernizojnë 2 hidrovorët e Hoxharë – Seman nr.2 dhe Darzezë nr.3, në Fier. Mundësojmë kështu përmirësimin e kullimit mbi 9,600 ha dhe i shërbejnë më shumë se 10,000 fermerëve.

Projekti i sigurisë së digave, një tjetër financim i Bankës Botërore prej 1.5 milionë Euro, që mbulon fazën e parafizibilitetit për 430 diga për të kaluar në fizibilitet, projekte zbatimi dhe ndërhyrje civile në digat prioritare.

Nga Qeveria Franceze vijnë 0.5 milionë euro për fizibilitet dhe projekte paraprake në 4 skema me ngritje mekanike që mbulojnë 8,500 ha.

Me shtesën e investimeve me rreth 700 milion për vitin 2026 do të kemi prioritet disa objekte të rinj të infrastrukturës kryesore të ujitjes ato në administrim të MBZHR dhe ato të Bashkive si dhe disa ndërhyrje në mbrojtjen nga përmbytja në zonat me risk të lartë.

Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor ka një buxhet prej 819 milion lekë në 2026, ose 8,2% më shumë krahasuar me 2025.

Ky është shërbimi që e zbret politikën në parcelë i jep fermerit zgjidhje të thjeshta, të matshme dhe në kohë.

Do të vazhdojmë financimin e 5 Qendra të Transferimit të Teknologjive Bujqësore dhe 4 Agjenci Rajonale të Ekstensionit që ofrojnë asistencë teknike falas për të rritur prodhimin dhe për të ulur kostot.

Bujqësia jonë është në një fazë të re dhe tani janë të nevojshme për fermerët si investimet ashtu edhe dijet, si mundësia për mbështetje ashtu edhe informacioni për ta bërë këtë mbështetje të përdorshme për të.

Efekti në sektor është i qartë dhe afatgjatë.

Ne parashikojmë që gjatë periudhës 2026–2028 të dorëzojmë 64 karta/paketa teknologjike, me synim informimin e më shumë se 100,000 fermerë që i adoptojnë ato .

Struktura e këshillimit informon dhe asiston fermerët në të katër cepat e Shqipërisë, trajnon 225 specialistë çdo vit, që cilësia e shërbimit të rritet vazhdimisht. Në të njëjtën periudhë, ndihmojmë fermerët për aplikimin në skemat kombëtare dokumente, faturim, gjurmueshmëri.

Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore ka një buxhet të planifikuar prej 25 milion lekë në 2026.

Me këtë fond ndërtojmë një sistem modern informacioni për tokën bujqësore që e kthen politikën në vendimmarrje me prova dhe na afron me praktikën e BE-së.

Karakterizojmë tipet e tokës me të gjithë elementët përbërës.

Llogarisim gjithashtu rrezikun aktual dhe potencial të erozionit.

Me këtë mbështetje, vendosim “inteligjencën” që rrit efektin e çdo lekut tjetër në buxhet: zgjedhje më të mira kulturash, ujitje më të mençur , skema më të sakta dhe siguri më e madhe për konsumatorin.

Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (2026) ka një buxhet të rritur prej 4%. Ky është “motori administrativ” që e kthen politikën në zbatim: përafron legjislacionin me kërkesat e BE, këshillon institucionet zbatuese si dhe biznesin gjithashtu koordinon me Komisionin European.

Të nderuar deputetë,

ky buxhet nuk është thjesht një tabelë shifrash është një paketë që e çon bujqësinë shqiptare një hap përpara drejt BE-së.

Në 2026 ne kalojmë nga logjika e shpërndarjes te logjika e rezultatit,

Skema mbështetëse si BE dhe kompensimi 10% i TVSH-së lidhin faturën me përfitimin duke sjellë formalizim, gjurmueshmëri dhe besueshmëri.

Kjo paketë, e mbështetur nga ujitja e sigurt, nga kontrolli zyrtar dhe laboratorët, nga këshillimi në terren e bën zinxhirin prodhim - grumbullim - përpunim të veprojë si një i vetëm.

Ky është buxheti i një vendi që negocion anëtarësimin dhe përgatitet për fondet pas-anëtarësimit në 2030.

Ai i jep fermerit rregulla të qarta , akses real në mbështetje dhe garanci se puna e mirë shpërblehet.

Ta miratojmë këtë buxhet do të thotë të zgjedhim prodhimin, cilësinë dhe eksportet,

Të zgjedhim që bujqësia shqiptare të ecë përpara, me ritmin dhe standardet e Evropës.

POLITIKA FISKALE

Të vetëpunësuarit në bujqësi marrin online vërtetimin e pagesës së kontributeve përmes e-Albania

Të vetëpunësuarit në sektorin e bujqësisë tashmë mund të sigurojnë në kohë reale vërtetimin e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore përmes platformës e-Albania.

Dokumenti gjenerohet menjëherë dhe pajiset me vulë elektronike, duke garantuar vlefshmëri të plotë ligjore

dhe eliminim të procedurave fizike.

Shërbimi elektronik “Vërtetim i pagesës së kontributeve të të vetëpunësuarve në bujqësi” u mundëson fermerëve dhe të vetëpunësuarve të marrin dokumentin pa pasur nevojë të paraqiten pranë sporteleve, duke kursyer kohë

dhe lehtësuar aksesin në procedurat administrative.

Kjo praktikë e re është pjesë e procesit të digitalizimit të shërbimeve publike, që synon të rrisë transparencën, të përmirësojë cilësinë e shërbimit dhe të mbështesë qytetarët në menaxhimin e detyrimeve të tyre ligjore.

Digjitalizimi i bujqësisë, vendoset në funksion sistemi european LPIS

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) po vijon me ritme të shpejta procesin e digjitalizimit të sektorit bujqësor, duke ngritur dhe vënë në funksion Sistemin e Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS) një mekanizëm kyç për menaxhimin transparent dhe efikas të fondeve të Bashkimit Evropian.

Drejtoresha e AZHBR-së, Ardita Kuçi tha se LPIS, bazohet në imazheri satelitore dhe standard të avancuara të BE-së.

“Ky sistem përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të administrimit të skemave të mbështetjes për fermerët shqiptarë. Ky sistem do të lehtësojë aplikimet online për subvencione, duke reduktuar burokracitë

dhe duke rritur saktësinë në verifikimin e të dhënave mbi sipërfaqet bujqësore”, shtoi ajo.

Falë teknologjisë së re, monitorimi i parcelave bujqësore do të kryhet në mënyrë të automatizuar dhe të vazhdueshme, çka pritet të rrisë ndjeshëm transparencën dhe përshejtimin e procesit në shpërndarjen e fondeve për fermerët.

Në të njëjtën kohë, LPIS do të ndihmojë institucionet shqiptare të përmbushin kushtet teknike dhe administrative që kërkojnë në kuadër të procesit të integritetit european.

“Implementimi i këtij sistemi përbën një element thelbësor për përputhjen me politikat e përbashkëta bujqësore të BE-së dhe shënon

një hap të rëndësishëm drejt rritjes së efikasitetit të shërbimeve ndaj fermerëve. Digjitalizimi i sektorit bujqësor vlerësohet si një nga prioritetet kryesore në rrugën e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian”, u shpreh Kuçi.

Me funksionimin e LPIS-it, fermerët do të kenë një proces më të thjeshtë, më të shpejtë dhe më të sigurt për marrjen e mbështetjes financiare, ndërsa vendi përfiton nga një sistem modern që siguron administrim të drejtë dhe të qëndrueshëm të fondeve bujqësore.

Këtë vit në skemën kombëtare të mbështetjes në bujqësi kanë aplikuar 70 mijë fermerë në shkallë vendi për tetë masa mbështetëse

Rikthimi i kompensimit të TVSH në bujqësi çorodit fermerët; Si do funksionojë skema

Paketa e re fiskale, që do të sjellë ndryshime në ligjin për TVSH-në, ka nisur të çorodisë fermerët lidhur me mënyrën e zbatimit.

Drejtesia të fabrikave të përpunimit të qumështit, veçanërisht në zonën e Juglindjes, pohuan se fermerët me NIPT po e kuptojnë gabim funksionimin e skemës, duke pretenduar se kompensimi do të jetë sa 10% e vlerës së autofaturave të lëshuara nga përpunuesit.

Por ky pretendim i fermerëve nuk është i saktë, pasi autofaturat që do të dorëzohen në administratën tatimore synojnë vetëm të dokumentojnë formalizimin e shitjeve mes fermerit dhe grumbulluesit. Pas dokumentit të formalizimit të shitjeve, me skemën e re fermeri do të marrë mbarsht 10% e TVSH-së që ka paguar kur ka blerë plehrat kimikë, farat, pesticidet dhe fidanët.

“Kompensimi i prodhuesve bujqësorë me normë fikse është një mekanizëm i TVSH-së, për ata fermerë që nuk i nënshtrohen TVSH-së dhe si të tillë, as nuk ngarkojnë TVSH për blerësit e produkteve të tyre bujqësore, por as kanë të drejtë të zbrisin TVSH-në e paguar në blerje. Norma e kompensimit të prodhuesve bujqësorë prej 10 për qind ka si qëllim t’i kompensojë ata për një pjesë të TVSH-së që paguajnë për inputet, në funksion të realizimit të prodhimeve të tyre bujqësore”, thuhet në relacion.

Për të përfituar, fermeri duhet të dorëzojë kërkesën pranë administratës tatimore, së bashku me autofaturat e lëshuara nga përpunuesi, grumbulluesi apo një agroturizëm i certifikuar që tregojnë NIPT-in e tij dhe numrin e llogarisë bankare.

Kërkesa për kompensim do të paraqitet dy herë në vit. Do të paraqitet brenda datës 31 Dhjetor, për furnizimet e kryera gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit përkatës. Brenda datës 30 Qershor të vitit pasardhës, për furnizimet e kryera gjatë periudhës Korrik-Dhjetor të vitit paraardhës. Kërkesa do të dërgohet në rrugë postare ose në rrugë elektronike. Administrata tatimore kryen kompensimin brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

Zbatimi i kësaj, përveç formalizimit të tregimit të produkteve bujqësore, synon të zbusë koston e prodhimit për fermerët, duke e lehtësuar me kompensim të TVSH të paguar për inputet bujqësore. Prej vitit 2019 deri në dhjetor 2021 TVSH-ja për inputet bujqësore ka qenë zero. Nga 1 janari 2022 me hyrjen në fuqi të ndryshimeve fiskale, nisi zbatimi i TVSH-së 10% për çmimet e inputeve bujqësore.

Si funksiononte skema e mëparshme

Deri në vitin 2017, rimbursimi i TVSH-së 20% për fermerin kalonte nëpërmjet përpunuesve

çka do të thotë se p.sh., për çdo blerje me faturë tatimore nga fermeri, përpunuesi mund të kreditonte këtë vlerë në TVSH-në e zbritshme. Kjo skemë e bënte ekonomiksht të leverdishme blerjen edhe me çmin të lartë për fermerin dhe siguronte marzh të qëndrueshëm fitimi për industrinë.

Nga viti 2019 deri në 2022, skema ndryshoi. Fillimisht në vitin 2019 TVSH-ja në blerje (nga fermerët) nga 20% u ul në 6%. Më pas skema u hoq plotësisht nga janari i vitit 2022.

Në vend të rimbursimit të TVSH-së, qeveria aplikoi subvencione direkte deri në 10,000 lekë për krerë bagëtie/lopë për fermerët.

Në relacionin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar” Ministria e Financave thekson se nga viti 2022 kur u vendos norma 0% e kompensimit për fermerët, ka pasur rritje dyfish të fermerëve që përfitojnë nga subvencionet dhe rritje dyfish të shumës së dhënë subvencion.

Për vitin 2024 janë rreth 14 mijë fermerë që kanë marrë 2,64 mld lekë subvencione. Nga viti 2022 është përfshirë në masat mbështetëse subvencionimi i naftës, nga e cila në vitin 2024 kanë përfituar rreth 31,500 fermerë në shumën prej 1,25 mld lekë.

Startup-et agro-ushqimore, motor i inovacionit në bujqësinë shqiptare

Më datat 7-8 nëntor 2025, Universiteti “Barleti”, në bashkëpunim me EIT Food, organizoi aktivitetin dyditor “EIT Food Challenge Labs & Agri-Food Startup Connect”, ku morën pjesë ekspertë të ushqimit, studentë, operatorë biznesi nga i gjithë vendi, përfaqësues të Dhomave të Tregtisë, si edhe drejtuesi i EIT Food për Europën Juglindore, Mirosław Raba.

Ky aktivitet, pjesë e programit ndërkombëtar të inovacionit EIT Food Challenge Labs CEE, kishte për qëllim nxitjen e ideve të reja, zhvillimin e modeleve të qëndrueshme të biznesit dhe forcimin e bashkëpunimit mes të rinjve, akademisë dhe industrisë agro-ushqimore. EIT Food është komuniteti më i madh evropian për inovacion

në sektorin agro-ushqimor, i mbështetur nga Bashkimi Evropian, që bashkon universitete, kompani, startup-e dhe qendra kërkimore me synimin për të ndërtuar një sistem ushqimor më të qëndrueshëm, më të shëndetshëm dhe më të përshtatshëm për sfidat e së ardhmes.

Universiteti “Barleti”, si partner i këtij komuniteti, luan një rol të rëndësishëm si urë lidhëse mes strukturave evropiane dhe ekosistemit shqiptar të inovacionit.

Në fjalën e tij, Presidenti i KASH, z. Agim Rrapaj, përshëndeti organizimin e këtij event duke theksuar nevojën për përmirësimin e bazës ligjore për startup-et, në mënyrë që ato të zhvillohen dhe të rriten në Shqipëri. Ai theksoi gjithashtu rëndësinë e mekanizimit të bujqësisë, si përgjigj-

ja më realiste ndaj mungesës së fuqisë punëtore dhe si parakusht për rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së fermave shqiptare. Gjatë dy ditëve të aktivitetit, u prezantuan disa ide inovative që synojnë të japin zgjidhje konkrete në zinxhirin agro-ushqimor, nga prodhimi deri tek konsumatori. Startup-i “Buzzy Beez” prezantoi një paketim miqësor me ushqimin dhe mjedisin, të prodhuar me dyll blete, si alternativë natyrale dhe e ripërdorshme ndaj plastikës. “Bioplastika” solli një paketim ushqimor të biodegradueshëm nga materiale krejtësisht natyrore dhe letër e ricikluar. Ndërkohë, “NutriVive AminoPlus50” u prezantua si biostimulanti i parë bio “Made in Albania”, një produkt natyral i zhvil-

luar dhe testuar në vend, që synon të rrisë rendimentin bujqësor dhe të ulë përdorimin e pesticideve.

Startup-et agro-ushqimore po shndërrohen sot në një hallkë të re dhe të rëndësishme të zinxhirit të ushqimit dhe bujqësisë. Ato ndërhyjnë drejt-përdrejt në sfida si mbrojtja e mjedisit, rritja e produktivitetit, reduktimi i mbetjeve, rritja e cilësisë së produkteve dhe ndërtimi i një bujqësie më të qëndrueshme. Përmes tyre, teknologjia dhe inovacioni po bëhen gjithnjë e më të pranishëm edhe në fermat shqiptare. Një rol të veçantë në këtë proces luajti bota akademike dhe sistemi i mentorimit. Universiteti “Barleti” tregoi se akademia nuk është vetëm një institucion arsimor, por një platformë lidhëse mes

startup-eve dhe biznesit, ku idetë marrin formë konkrete dhe lidhen me tregun. Mentorët, pedagogët dhe ekspertët e angazhuar në këtë projekt ndihmuan ekipet të strukturujnë idetë e tyre, t’i kthejnë ato në modele biznesi të qëndrueshme dhe t’i përshtasin me nevojat reale të sektorit agro-ushqimor.

Në mbyllje të aktivitetit u vlerësuan 6 startup-et fituese, duke reflektuar potencialin dhe angazhimin e të rinjve shqiptarë në ndërtimin e një bujqësie moderne.

Ky event solli jo vetëm ide, por edhe një model të ri bashkëpunimi, ku startup-et sjellin inovacionin, bizneset krijojnë mundësitë e tregut dhe bota akademike shërben si urë lidhëse mes dijes, teknologjisë dhe ekonomisë reale. Univer-

siteti “Barleti”, si partner i EIT Food, tregoi se institucionet akademike nuk duhet të mbeten vetëm në rolin e transmetuesve të dijes teorike, por të shndërrohen në inkubatorë idesh dhe katalizatorë zhvillimi, ku studentët dhe studiuesit ndërtojnë zgjidhje konkrete për sektorin agro-ushqimor.

Në një kohë kur bujqësia shqiptare po përjeton një krizë demografike dhe strukturore, iniciativa të tilla dëshmojnë se e ardhmja nuk ndërtohet vetëm me subvencione apo politika, por me ide, dije, bashkëpunim dhe besim tek të rinjtë. Dhe pikërisht në këtë ndërthurje mes akademisë, biznesit dhe startup-eve qëndron shpresa reale për një bujqësi shqiptare moderne, konkurruese dhe të qëndrueshme.



Në datat 7-8 nëntor 2025, Universiteti Barleti zhvilloi me sukses aktivitetin përmblyllës të projektit “EIT Food Startup Awareness Event - Albania”



AKTUALITET

UBT feston 74-vjetorin, Sallaku: Shkenca dhe inovacioni, baza e bujqësisë së të ardhmes

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) ka festuar 74-vjetorin e themelimit të tij, duke shënuar më shumë se shtatë dekada në shërbim të dijes, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të bujqësisë shqiptare.

Ceremonia e këtij përvjetor

Në fjalën e tij përshëndetëse, rektori i Universitetit Bujqësor



tori u shoqëruan me organizimin e Konferencës Ndërkombëtare mbi Shkencat e Jetës dhe Bujqësinë, ku morën pjesë Kryeministri Edi Rama, pedagogë, ekspertë nga Europa dhe vende të tjera të botës.

Në qendër të diskutimeve ishin sfidat dhe mundësitë e një bujqësie të qëndrueshme, që respekton natyrën dhe kontribuon në fuqizimin e ekonomisë rurale.

të Tiranës, prof. dr. Fatbardh Sallaku, u shpreh se ky përvjetor përkon me një periudhë transformimi të thellë për universitetin.

“Sot UBT feston 74 vite histori, duke mbetur kështjella e dijes në bujqësi. UBT ka kaluar kohë të vështira, por ka ditur të ngrihet më i fortë. Së fundi kemi nisur reforma të rëndësishme që po e kthejnë universitetin në një kampus modern, që performon

dije dhe krijon standarde të reja akademike”, tha ai.

Sipas Sallakut, këto reforma po reflektohen edhe në interesin e studentëve. “Këtë vit kemi shënuar një rritje të ndjeshme të regjistrimeve, me rreth 20% më shumë studentë krahasuar me një vit më parë. Kjo tregon se të rinjtë po e shohin UBT-në si një mundësi reale për formim profesional dhe punësim”.

Rektori kujtoi se ka patur një periudhë kur Universiteti kishte humbur identitetin e tij, por falë vizionit të ri dhe mbështetjes së qeverisë, institucioni po kthehet në një simbol të dijes dhe kërkimit shkencor. “UBT është dëshmi se me këmbëngulje dhe bashkëpunim çdo institucion mund të ringrihet. Falë reformave të ndërmara dhe mbështetjes së Kryeministrit Edi Rama, sot jemi në rrugën e duhur për t’u bërë një partner i besueshëm akademik dhe shkencor, si brenda vendit ashtu edhe në arenën ndërkombëtare”, theksoi ai.

Ai u ndal në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe vizionin për

një bujqësi të gjelbër.

Sallaku falënderoi partnerët ndërkombëtarë që kanë kontribuar në suksesin dhe modernizimin e universitetit, si Gjermania, Austria dhe Kazakistani, teksa vuri në dukje se, “një vend të veçantë në këtë bashkëpunim



zë Universiteti BOKU i Vjenës, i cili është tashmë pjesë e rrjetit akademik të UBT-së, duke i dhënë një dimension të ri zhvillimit shkencor dhe akademik të këtij institucioni”.

“Falë bashkëpunimit me rr-

jetet shkencore ndërkombëtare, me universitetet europiane, me ekspertët e diasporës shqiptare dhe me partnerët tanë nga SHBA, UBT është bërë një institucion i njohur në arenën ndërkombëtare. Ne po ndërtojmë një histori suksesi që

forcon pozicionin e Shqipërisë në fushën e kërkimit bujqësor”, u shpreh Sallaku.

Në përfundim të fjalës së tij, ai nënvizoi se misioni i UBT-së është që të përkthejë zhvillimet ndërkombëtare në dije të zbat-

ueshme për fermerët shqiptarë. “Në një kohë kur bota po flet për zhvillimin green, UBT ka misionin të bëjë që ky zhvillim të kthehet në dije konkrete dhe në teknologji të matshme për fermerin tonë. Shqipëria ka nevojë për një universitet të fortë që kontribuon me dije dhe inovacion në bujqësinë e së ardhmes”, përfundoi Rektori.

Punimet e Konferencës synojnë të forcojnë lidhjen midis shkencës, inovacionit dhe praktikave bujqësore, si pjesë e vizionit për një Shqipëri Europiane 2030, ku teknologjia dhe dijet moderne janë aleatët më të fortë të fermerëve dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Universiteti Bujqësor i Tiranës mbetet një nga institucionet më të rëndësishme të arsimit të lartë në vend, me kontribut të pazëvendësueshëm në zhvillimin e bujqësisë, shkencave të jetës dhe mjedisit. Me një histori që fillon në vitin 1951, UBT ka përgatitur mijëra specialistë që kanë udhëhequr sektorin bujqësor shqiptar ndër vite. Sot, në përvjetorin e 74-t, ky institucion po hyn në një fazë të re të modernizimit, ku kërkimi shkencor, teknologjia dhe bashkëpunimi ndërkombëtar janë shtyllat mbi të cilat po ndërtohet e ardhmja e tij.

Salla: Standard i ri dinjiteti në zonat rurale me hapjen e negociatave për bujqësinë

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) shënoi 74-vjetorin e themelimit

sektorin edhe në kohët më të vështira. Ky kampus është kre-



Salla e cilësoi aktivitetin shkencor si një moment reflektimi dhe vizioni drejt një bujqësie moderne, inovatore dhe të harmonizuar me standardet europiane.

“UBT ka qenë për 74 vite kështjella e dijes bujqësore në Shqipëri. Ka përgatitur agronomë, veterinerë dhe specialistë që kanë mbajtur gjallë

nari kombëtare, sepse aty ku ka dije, ka zhvillim dhe jetë”, u shpreh ministri.

Ai shprehu mirënjohje për partnerët ndërkombëtarë të UBT-së nga SHBA, Anglia, Gjermania, Italia dhe veçanërisht Universitetin BOKU të Vjenës, duke e vlerësuar bashkëpunimin mes dy institucioneve si një model suksesi në fushën e ar-

simit dhe kërkimit shkencor.

“Bashkëpunimi mes UBT-së dhe BOKU është një shembull konkret se si arsimit dhe shkencat udhëheqin ndryshimin real. Kjo është rruga që duhet të ndjekim për të ndërtuar një bujqësi moderne dhe konkurruese në tregun europian”, tha ai.

Gjatë fjalës së saj, ministri ndaloi te rrugëtimi i Shqipërisë drejt Bashkimit Europian, duke theksuar rëndësinë e kapitujve 11, 12 dhe 13, që lidhen me bujqësinë, sigurinë ushqimore dhe peshkimin.

“Përmes këtyre kapitujve, po ndërtojmë një standard të ri dinjiteti për njerëzit tanë në zonat rurale. Kjo është një punë që kërkon bashkëpunim të ngushtë mes institucioneve, akademisë, sektorit privat dhe vetë fermerëve”, u shpreh Salla.

Ministri vuri theksin në tri shtyllat kryesore të këtij procesi: Kapitulli 11 – Bujqësia dhe Zhvillimi Rural; ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe ndërtimi i një sistemi transparent për

regjistrimin e parcelave, si bazë për zbatimin e politikës së përbashkët bujqësore të BE-së;

Kapitulli 12 – Siguria Ushqi-

me rregullat e BE-së.

Në vijim, ministri renditi disa nga prioritetet konkrete të ministrisë në këtë proces: Rritja



more: krijimi i një sistemi digjital kombëtar për gjurmimin e produkteve bujqësore, që garanton siguri, kontroll dhe certifikim sipas standardeve europiane, Kapitulli 13 – Peshkimi dhe Burimet Detare: përforsimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve detare dhe përafrimi

e kapaciteteve profesionale dhe reformimi i strukturave për të garantuar efikasitetin në çdo institucion; Punësimi i të diplomuarve të ekselencës nga UBT, të cilët do të kenë përparësi në çdo vakancë në institucionet e varësisë; Krijimi i Urdhrit të Agronomit, një nismë ligjore që

do të rregullojë dhe licencojë profesionin e agronomit, duke garantuar cilësi, përgjegjësi dhe zhvillim profesional të vazhdueshëm.

“Ky mision është moral, jo vetëm politik”, tha ai.

Në fund të fjalës së tij, ministri ndau një reflektim personal mbi përvojën e tij me jetën rurale. “E njoh nga afër jetën e fshatit dhe sfidat e përditshme të fermerëve. Për mua, ky mision nuk është thjesht politik është detyrim moral dhe njerëzor. Nuk premtoj gjithçka, por premtoj të bëj ato që janë jetike për bujqësinë, biznesin dhe ekonominë shqiptare”, u shpreh Salla.

Ai përmbylli fjalën me një mesazh bashkëpunimi dhe besimi.

“Asnjë reformë nuk do të jetë e qëndrueshme pa dijen që lind në këtë universitet. Ministria e Bujqësisë do të jetë partnere e hapur dhe e palodhur për të ecur përpara së bashku me UBT-në. Do të bëjmë që fshati të jetë më i zhvilluar, fermeri më i mbrojtur, agronomi më i respektuar dhe produkti shqiptar më i vlerësuar. Stacioni ynë i ardhshëm është Bashkimi Europian dhe UBT është një nga aleatët tanë më të çmuar në këtë rrugë”, deklaroi Salla.

Ata ngulin këmbë se ky është një nga faktorët që ka ndikuar në shtrenjtimin e produktit në Kosovë.

Në përgjithësi, ngritja e çmimeve edhe këtë vit ka vazhduar hovshëm, sidomos produktet ushqimore, duke tejkaluar mesataren e viteve të fundit. Sipas të dhënave, deri në nëntor të këtij viti, grupi i produkteve ushqimore zë vendin kryesor të shpenzimeve në familjet kosovare.

Eksporti i vezëve në Shqipëri rrit çmimet në Kosovë - Vlera e produktit në supermarkete tejkalon nivelet e pasluftës

tori mund ta gjejë çmimin e produktit më shumë se 6 euro.

Ndërkohë, në dyqanet e prodhuesit dhe tregtarit më të njohur të prodhimeve të shpendëve “Konsoni”, vlera e vezëve papritmas shkoi nga 4,50 euro kompleti në 5 euro,

një rritje mbi 10 për qind.

Për rritjen ekstreme të këtyre ditëve të çmimit të vezëve nuk ka asnjë shpjegim zyrtar dhe as nga prodhuesit. Shitësit justifikohen duke u shprehur se “çmimin nuk e përcaktojnë ata, pasi vetëm tregtojnë produk-

tin”. Sipas ekspertëve të sektorit, Kosova ka kapacitete të mjaftueshme të pularive për të plotësuar nevojat e banorëve të vendit me vezë. Nga ana tjetër, nuk ka ndonjë ngritje çmimi të materialit riprodhues, as të misrit apo të produkteve

të tjera të nevojshme për ushqimin e shpendëve.

Vrojtues të tregut kanë shpjeguar se shumë prodhues të vezëve në Kosovë po i eksportojnë vezët në Shqipëri, për shkak të ofertës së lartë dhe çmimeve të leverdishme.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



HOMAZH

Gjurmë të punës së Agronomit Gjergji Qafko në Shqipëri dhe Kanada

“Puna i jep shkëlqim rinisë dhe nder pleqërisë.” - Balzak

Nga: Fuat Memelli, Boston



Gjergji Qafko

Para disa javësh u nda nga jeta Gjergji Qafko, një nga specialistët e shquar të bujqësisë shqiptare, jo vetëm të rrethit të Korçës, por edhe përtej saj. Pas viteve 1990 si shumë shqiptarë edhe ai bashkë me familjen emigroi në Kanada. Kishte ardhur me pushime në Shqipëri, ku ndër të tjera bëri pagëzimin e mbesave të tij dhe nipit të motrës, por nuk ariti të kthehej përsëri në Atdheun e dytë. Ndrroi jetë në qytetin e Korçës në shtëpinë e motrës. E ka dashur shumë Shqipërinë, Korçën ku punoi e jetoi si dhe Zvirinën , fshatin ku lindi dhe u rit, pasi siç ka thënë Horaci “qiellin por jo shpirtin ndryshon ai që shkon përtej detit.” Do prehet në vendlindje pranë prindërve të tij. Ndoshta se jetoi 25 vjet larg Shqipërisë e nuk u çmall dot me të, me njerëzit e tij që jetonë aty, me shokët e miqtë, Zoti e solli të prehet në Atdhe. Për të mbledhur më shumë ”miell” për këtë shkrim, u desh vajtja gjatë ditëve të fundit në Kanada ku jetojnë dy djemtë e mi, ku mora mjaft të dhëna e foto nga bashkëshortja e tij, Evanthi Qafko dhe vajzat e tij, Anxhela dhe Vali.

Në Shqipëri dhe...

Për ata që nuk e kanë njohur, po shpalosim disa kapituj nga rruga e jetës së tij 68 vjeçare. Kishte lindur në fshatin e bukur Zvirinë të Korçës, që shquhet për kultivimin e mollëve. Ishte një nga katër fëmijët e kësaj familje, dy djem e dy vajza. Mësimet e para i mori në vendlindje, të mesmen në Maliq ndërsa të lartën në Institutin Bujqësor të Korçës, sot universitet, të cilin e mbaron me rezultate të larta, me notën mesatare 9,9. Punën e parë si agronom e filloi në vitin 1982 në kooperativën e Pirgut. Më pas në vitin 1983, rrugëtimi i tij vazhdon në Stacionin e Panxharit në Korçë, në fillim specialist, ndërsa në vitin 1992 e deri në vitin 2000 drejtor i këtij stacioni. Në tokat e stacionit, veç panxharit kultivohej edhe grurë, fasule, etj. Gjatë kohës që punonte këtu, ka dhënë mësim si i jashtëm në Universitetin e Korçës. E kam intervistuar disa herë dhe fliste si bilbil. Me skenarin e tij kemi realizuar edhe një dokumentar për teknologjinë e kultivimit të panxhar sheqerit. Vëllai i tij, Pandeli Qafko, i cili ka mbaruar për mësuesi dhe jeton në qytetin Quincy afër Bostonit, më tregoi se për të mbrojtur stacionin nga trazirat e vitit 1997, bashkë me Gjergjin shkonin natën në stacion dhe tok me disa punëtorë të armatosur, e mbrojtën objektin nga shkatërrimi. Ai më tha se Gjergji ishte besimtar i madh dhe jepte donacione për bamirësi.

Duke patur parasysh se çdo gjuhë e huaj që mëson, është një dritare më shumë për të parë botën, krahas njohurive në fushën e agronomisë, përvetësoi edhe me disa gjuhë të huaja. Si bashkëshortja edhe i vëllai më thanë se Gjergji dha provimin për gjermanisht, mësoi anglisht, rusisht e më pas edhe gjuhën greke. Një hap tjetër i rëndësishëm në rrugën e jetës së tij ishte specializimi tre muaj në Gjermani për panxharin, për teknologjinë e farërave dhe resurset gjetetike. Kualifikim tjetër bëri në Danimarkë e Bullgari. Duke njohur mirë gjermanishten, përkthente kur vinin delegacione në Korçë, por e kanë thirrur edhe në Tiranë. Gjergji e donte shumë natyrën, traditat e fshatit, ushqimet, këngët e vallet. Shkonte shpesh në Zvirinë, vendlindjen dhe tok me specialistë të tjerë ndihmonte fshatarët me ekspertizë për farërat e grurit, elbit, panxharit e patates si dhe për mbrojtjen e bimëve. Shkonte edhe në Sinicë, vendlindjen

e bashkëshortes.

... Kanada

Ishte korriku i vitit 2000, kur me aplikim shkoi me familjen në Kanada, në qytetin Mississagua ku ngrii follenë e familjes së tij. Si për çdo mërgimtar, fillimi ishte i vështirë edhe për Gjergjin. Por, njeriu i punës gjen forca dhe përshtatet. Anglishtja të cilën e zotëronte mirë, e ndihmoi të çajë vështirësitë e para të emigracionit. Kështu në vitin 2001 konvertoi diplomën e agronomit të lartë, nëpërmjet Shërbimit të Vlerësimit Ndërkombëtar Kanadez, duke e njësuar me atë të Kanadasë. Në vitin 2002, duke vazhduar studimet për 52 javë, diplomohet në Institutin e Teknologjisë së Prodhimit të Ilaçeve në Toronto, duke marrë edhe medalje Nderi. Punoi në disa vende si në kompaninë Costco, ku hartoi një program që të ishte më eficient për lëvizjen e mallrave. Duke patur një përvojë të gjatë si agronom, punoi edhe në kopshtet e familjeve kanadeze, etj.

Njeri me zemër të madhe që jepte gjithmonë, pa kërkuar asgjë në këmbim

Ishte 68 vjet kur u nda nga jeta. Qe i fortë dhe kishte energji, por vdekja nuk pyet. La pas bashkëshorten e tij Evanthinë (edhe ajo agronome e lartë) me origjinë nga familja Guta e Sinicës. La pas edhe dy vajzat Anxhelen, e cila ka mbaruar universitetin në Toronto për biologji e psikologji, ndërsa Vali ka mbaruar shkencat sociale dhe është mësuese. La pas edhe vëllanë e tij Pandeliun që jeton në Amerikë si dhe dy motrat në Shqipëri. Shokët e tij agronomë të një jete, që prej 25 vitesh jetonin edhe ata në Kanada si Edmond Sërbo, Nikolla Filo, Thoma Plaku, Kristaq Vishja, Blendi Qinami e Kastrot Vinçani, nuk u ndodhën kur ai ndrrroi jetë, por i dërguan një mesazh prekës familjes dhe të afërmve. Ndër të tjera theksonin.” Do të kujtojmë gjithmonë Gjergjin të qeshur, të dashur, të singertë, me humor të këndshëm, njeri me zemër të madhe, që jepte gjithmonë, pa kërkuar asgjë në këmbim.” Le të jenë edhe ky shkrim nga Bostoni, si një buqetë me lule në kujtim të Tij.



Me bashkëshorten dhe dy vajzat në Kanada



Në një takim me specialistë gjermanë dhe shqiptarë



Duke përkthyer në një kioskë pas viteve 1990



Në Sinicë



Në diplomimin e nipit në Universitetin e Bostonit



Në dasmën e njëres prej vajzave

INFORMACIONE


Kina vazhdon luftën për të konsoliduar rezultatet e zhdukjes së varfërisë



një korre të bollshme të hurmave në qytetin Guilin të Rajonit Autonom Guangxi të Kinës jugperëndimore/Foto nga VCG

Në shkurt të vitit 2021, Kina shpalli një fitore të plotë në betejën e saj kundër varfërisë, duke arritur këtë moment historik dhjetë vjet përpara objektivit të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm. Kina midis viteve 1980 dhe 2020 nxori nga varfëria rreth 800 milionë njerëz, duke kontribuar gjatë kësaj periudhe në rreth 75 përqind të reduktimit të varfërisë globale. Presidenti i Bankës Botërore ka venë në dukje se sukseksi i Kinës ndihmoi në uljen e shkallës globale të varfërisë nga 44 përqind në 9 përqind, duke e bërë atë kontribuuesin më të madh në zbutjen e varfërisë globale në dekadat e fundit. Sukseksi i Kinës në zbutjen e varfërisë jo vetëm që ka transformuar jetën e brendshme, por gjithashtu ka ofruar përvojë të vlefshme për vendet e tjera në zhvillim që kërkojnë rritje të qëndrueshme.


shëm i OKB-së, Antonio Gutierrez, vlerësoi arritjet e Kinës si "një burim shprese dhe frymëzimi për të gjithë bashkësinë ndërkombëtare", duke theksuar se angazhimi i fortë politik dhe qëndrueshmëria e politikave janë thelbësore për përmirësimin e jetës së më të varfërve dhe më të prekshtëmëve. Në shume vende të Azisë, Afrikës dhe Amerikës Latine, eksperiencia kineze po i ndihmon vendet partnere të ndërtojnë kapacitete, të forcojnë infrastrukturën dhe të zhblokojnë potencialin e zhvillimit. Modernizimi bujqësor dhe rural ka pasur një ndikim të madh në modernizimin e vendit në tërësi. Politikat e zbatuara në vazhdim të suksesit kanë synuar promovimin e zhvillimit të integruar urban-rural, të konsolidimit dhe zgjerimit të arritjeve në zbutjen e varfërisë, dhe të sigurimit të kushteve modern të jetesës në zonat rurale.



Në një letër urimi të vitit 2021, Sekretari i Përgjith-

Në vend që të mbështetjet vetëm në rritjen ekonomike,

Kina kombinoi lehtësimin e synuar të varfërisë, investimet në infrastrukturë dhe mobilizimin social për të siguruar që asnjë rajon apo grup të mos lihej pas. Këto politika kanë kontribuar dhe në uljen e pabarazisë ndërmjet zonave urbane dhe rurale, si dhe në standardin e jetesës. Treguesi më i dukshëm është hendeku i të ardhurave dhe i shpenzimeve midis zonave urbane dhe rurale. Hendeku i të ardhurave midis banorëve ruralë dhe qytetarë është ulur nga 3.1 në vitin 2004, në rreth 2.3 në vitin 2024. Ndërsa hendeku i shpenzimeve për banor është ulur nga 3.5 në vitin 2004, në 1.8 në vitin 2024.



Për të mbajtur varfërinë nën kontroll, Kina ka zbatuar një sërë planesh dhe masash mbrojtëse të politikave të nivelit të lartë. Pas suksesit të fushatës për zbutjen e varfërisë, në fund të vitit 2020 në një periudhë tranzicioni pesëvjeçare është synuar për të siguruar rajonet ashtu edhe individët e nxjerrë nga varfëria të marrin mbështetje të vazhdueshme. Gjatë kësaj periudhe është zbatuar një mekanizëm dinamik monitorimi dhe ndihme për ata që janë në rrezik të kthehen në varfëri, duke përfshirë familjet që kanë shpëtuar së fundmi nga varfëria dhe ata që janë në prag të rënies përsëri në varfëri. Ky sistem përmban kontrolle të rregullta dhe menaxhim dinamik për të siguruar zbulimin, ndërhyrjen dhe mbështetjen e hershme. Masat specifike për të konsoliduar arritjet e zbutjes së varfërisë përfshijnë ndihmën industriale, mbështetjen e punësimit dhe sigurimet

shoqërore.

Në 832 zona të cilat u hoqën nga lista e varfërisë ekstreme në vitin 2020, janë zhvilluar dy deri në tre industri kryesore, me një vlerë totale prodhimi që tejkalon 1.7 trilion juanë ose 230 miliardë USD. Duke rritur cilësinë dhe efikasitetin e këtyre industrive, është arritur të sigurohet një burim i qëndrueshëm të ardhurash për ata që dalin nga varfëria. Deri në fund të vitit 2024, numri i të punësuarve nga zonat e prekura nga varfëria arriti në 33.05 milionë, duke ruajtur një nivel të qëndrueshëm mbi 30 milionë për katër vjet rresht. Të ardhurat e disponueshme rurale në qarqet e mëparshme

të varfra, janë rritur ndjeshëm, duke u rritur nga 6,079 juanë në vitin 2013 në 16,396 juanë ose 2,316 USD në vitin 2023. Kjo rritje e qëndrueshme e të ardhurave pasqyron ndikimin afatgjatë të përpjekjeve të Kinës për lehtësimin e varfërisë në komunitetet rurale.

Si dhe po përmirësohet sistemi i tyre i sigurimeve sociale shumë niveleshe për të siguruar që individët e nxjerrë nga varfëria të marrin mbështetje të vazhdueshme në arsim, kujdes shëndetësor, strehim dhe fusha të tjera. Këto përpjekje kanë qenë të rëndësishme në parandalimin e rikthimit në varfëri. Deri në fund të Nëntorit 2024, rreth 5.34 milionë njerëz që rrezikonin të binin në varfëri janë ndihmuar, duke eliminuar në mënyrë efektive rrezikun e rënies në varfëri. Në zona të largëta, ose të prirura ndaj fatkeqësive, qeveria ka zbatuar programe zhvendosjeje në shkallë të gjerë, duke zhvendosur banorët nga mjedise të

pafavorshme në komunitete të ndërtuara rishtas të pajisura me banesa, shkolla, spitale dhe institucione kujdesi për të moshuarit. Në rajonet me potencial më të madh u zhvilluan industritë lokale si bujqësia e specializuar, turizmi rural dhe tregtia elektronike, për të krijuar vende pune dhe për të stimuluar ekonominë lokale. Arsimi ka qenë gjithashtu një faktor i rëndësishëm për thyerjen e ciklit të varfërisë ndër gjenerata. Përmes iniciativave të tilla si rekrutimi i mësuesve ruralë dhe ofrimi i ndihmës financiare për studentët në nevojë, më shumë se 200,000 fëmijë në moshë shkollore nga familje të varfra kanë qenë në gjendje të kthehen dhe të përfundojnë arsimin e detyrueshëm.



Parku i Ekspozitës Bujqësore të Xinjiang-ut/Foto nga VCG

Në rekomandimet për formulimin e Planit të 15-të Pesëvjeçar për Zhvillimin Ekonomik dhe Social Kombëtar kërkohej krijimi i një sistemi të kategorizuar ndihme për banorët me të ardhura të ulëta dhe rajonet e pazhvilluara në zonat rurale. Përvoja e fituar në Programin e Ringjalljes së Gjellbër Rural në Provincën Zhejiang në zhvillimin e një fshati të bukur dhe harmonik, ku njerëzit të jetojnë dhe punojnë bazuar në kushtet lokale, është një eksperiencë e vlefshme për të avancuar sistematikisht ringjallërimin rural. Në rekomandimet për formulimin e Planit të 15-të Pesëvjeçar për Zhvillimin Ekonomik parashikohen

një sërë masash si: përpjekje të koordinuara për të çuar përpara qeverisjen e hapësirës territoriale; përmirësimin e planimetrive të fshatrave dhe qyteteve; përmirësimin e tokës; ndërtimin e sistemeve më të plota infrastrukturorë për t'i bërë shërbimet publike më të arritshme; përmirësimin e mjedisit jetësor në zonat rurale; ndërtimin dhe mirëmbajtjen e integruar të infrastrukturës së qarkut si dhe përmirësimin e mjedisit të jetesës rurale; si dhe adresimin e mangësive në ofrimin e pajisjeve të duhura modern për të krijuar hapësira të mira jetese në zonat rurale.

Gjithashtu do të duhet të zhvillohen ekonomitë e qarkut me karakteristika unike, për të eksploruar funksione të



Parku i Ekspozitës Bujqësore të Xinjiang-ut/Foto nga VCG

shumëfishta të bujqësisë dhe të promovojnë integrimin më të madh të sektorëve parësorë, dytësorë dhe terciarë në zonat rurale. Përpjekjet do të duhet të jenë të koordinuara për të krijuar mekanizma të rregullt për të parandaluar që banorët ruralë të bien ose të rikthehen në varfëri. Kjo do të kërkojë ndihmë shumëplanëshe dhe të kategorizuar për zonat e pazhvilluara, të zbatimit të politikave që mbështesin qarqet kryesore që kanë nevojë për ndihmë në arritjen e ringjallërimin rural dhe të kërkohej të bëhet çdo përpjekje për t'u mbrojtur nga çdo rënie ose rikthim në varfëri në shkallë të gjerë.


Rritet numri i të imtave në Lunxhëri, ky është momenti më i vështirë, por edhe i bukur i vitit

Për blegtorinë, kjo periudhë shënon momentin më të ndjeshëm të vitit, atë të shtimit të të imtave. Si pasojë, ato kërkojnë kujdes të shtuar. Blegtorët e zonës së Lunxhërisë, në Bashkinë Gjirrokastër, i kanë zbritur tufat nga mali drejt staneve për t'u kujdesur gjatë këtij procesi të rëndësishëm.

"Është koha e shtimit tani dhe duhet kujdes, duhen ushqyer patjetër. Vendi duhet të jetë i ngrohtë", tha blegtori

Blegtorët thonë se ky ka qenë një vit i mbarë për prodhimin e të imtave. Sipas tyre, kërkesa ka qenë e lartë,

pavarësisht se baxhoxhinjtë shpesh kërkojnë produktin me çmime më të ulëta. Interes për produktet e tyre, si qumështi, djathi apo mishi, po tregojnë



edhe turistët e huaj që vizitojnë zonën.

"Mishin, qumështin, por nuk u pëlqejnë çmimet. Sigurisht që e duan dhe të huajt, kujt nuk i shijon një sheleg në hell. E tregtojmë në baxho në Sarandë", tha blegtori.

Me gjithë sfidat e përditshme, blegtorët e Lunxhërisë vijojnë të ruajnë traditën dhe të furnizojnë tregun me produkte cilësore. Ata shpresojnë që institucionet dhe tregu t'i mbështesin më shumë, në mënyrë që kjo veprimtari e hershme të vazhdojë të jetë një burim sigurie dhe zhvillimi për zonën.

Përgatitja e tokave për pemët frutore, rritje e sipërfaqes me ullinj në Postribë

Nëntori është periudha ideale për përgatitjen e tokës për pemët frutore. Në njësinë administrative Postribë është vënë re një rritje e ndjeshme e interesit për kultivimin e ullirit. Nga një zonë që 30 vite më parë kishte thuhet zero sipërfaqe të mbjella me ullinj, sot Postriba numëron dhjetëra parcela të kthyer në plantacione të mirë strukturuar.

"Interes të shtuar ka bima e ullirit, tani janë krijuar plantacione me ullinj dhe që japin prodhim", u shpreh Sherif Brahaj, Specialist i AREB Shkodër.

Fermerët e zonës po investojnë gjithnjë e më shumë në këtë kulturë, e cila jo vetëm i përshtatet klimës së butë mesdhetare të Shkodrës, por



garanton edhe prodhim të qëndrueshëm gjatë gjithë vitit. Ulliri kultivohet kryesisht për prodhimin e vajit, ndërsa sasia që sigurohet nga plantacionet aktuale mbulon pothuajse të gjithë nevojat e konsumit vendas në Postribë.


"Kryesisht kemi ullinj për vaj", tha ai.

Rritja e numrit të ullishtave në Postribë është një shembull i transformimit bujqësor të zonave rurale të Shkodrës, duke i orientuar ato drejt kulturave që sjellin prodhim, cilësi dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

BOTIME

Një libër i Prof. Dr. Tatjana Dishnica dhe mesazhet me vlerë që ai jep

Kam pasur fatin ta njoh Tatjanën, shumë vite më parë, kur ajo drejtonte institutet kërkimore dhe shërbimin e ekstensionit bujqësor në Ministrinë e Bujqësisë. Ajo ishte një figurë e ngarkuar me



përgjegjësi, duke menaxhuar struktura të rëndësishme të sektorit bujqësor, por gjithmonë e matur, aktive dhe e hapur për të ndarë informacionin. Një shprehje e saj më ka mbetur gjithmonë në mendje: “Patjetër Etleva, të ndihmoj unë, informacioni është produkt publik, dhe nuk duhet ta monopolizojmë.” Kjo e përshkruan karakterin e saj: një zjarrtarë miqësor, e thjeshtë, pa asnjë mburrje për origjinën e saj apo titujt shkencorë. Me kujtohet gjithashtu atëhere, kur ajo me fliste për eksperimentet e thjeshta që bënte gjatë punës së saj si agronome në terren dhe përdorimin e atyre makinave të vogla llogaritëse, me të cilat detyrohej të bënte mijra veprime, të një eksperimenti tre faktorial, kohë, kur kompjuteri as që dukej ne horizont.

Papritur, pas shumë vitesh, mora një ftesë për promovimin

e një libri të saj. U habita – ishte e qartë se Tatjana kishte ruajtur kontaktin dhe dinte se e vlerësoja. Libri, i titulluar “Memorja Shqiptare: Një shekull kërkime dhe institucione bujqësore”, u promovua më 11 nëntor 2025 në Institutin Shqiptar të Studimeve Ndërkombëtare. Por, para se të flas për librin, le të rikthehemi tek karriera e saj, të cilën Tatjana, e përmbledhi shkurtimisht në fjalën e saj të mbajtur gjatë promovimit të librit të saj.

Endrra e Tatjanës ishte mjekësia, duke ndjekur hapat e të atit, Doktor Ymer Dishnica, që kish studjuar në Francë dhe në vitet ’40 dhe kishte mbrojtur doktoraturën në Universitetin e Sorbonës. Megjithatë, për rrethanat e kohës, ajo u orientua drejt agronomisë dhe mbaroi me rezultate të shkëlqyera Institutin e Lartë Bujqësor, duke punuar për 13 vite si agronome në terren, në kooperativa të rrethit të Beratit. Gjatë këtyre viteve, Tatjana përgatiti edhe disertacionin e doktoraturës, duke sfiduar pengesat që iu vunë para.

Hapat e mëtejshme të karrierës së saj nuk njohin “katapultim”, por ecuri dhe pozicione, me shumë punë e përpjekje. Në fillim të viteve ’90, ajo mbrojtë doktoraturën dhe u emërua pedagoge në Universitetin Bujqësor. Më pas, Tatjana Dishnica u angazhua në Komitetin e Shkencës dhe Teknologjisë, ku kontribuoi në Ligjin për Shkencën dhe Programet kom-

bëtare për kërkim dhe zhvillim. Drejtoi Institutin e Studimit të Tokave për dy vjet dhe më pas për afro 20 vite drejtoi Institutet Kërkimore dhe Shërbimin e Ekstensionit në Ministrinë e Bujqësisë.



Pas vitit 2013, rikthehet në jetën akademike dhe tashmë vazhdon të japë leksione si profesore e ftuar, duke ndarë pasionin dhe përvojën me studentët e saj. Tatjana është e angazhuar në shoqërinë civile, për mbështetjen e grave në zonat rurale

Për karrierën e saj, Tatjana u shpreh: Unë jam një agronome, por: “Jeta ime në bujqësi ndërthur praktikën në terren, drejtimin institucional dhe arsimin”.

Botimi i saj i fundit, “Memorja Shqiptare: Një shekull kërk-

kime dhe institucione bujqësore”, është një botim shqip me një përmbledhje të zgjeruar në anglisht.

Bazuar në qindra dokumente arkivore dhe përvojën e saj të gjatë në administratën publike, Tatjana dokumenton historikun, fillesat e kërkimit bujqësor, ekstensionit dhe informacionit bujqësor, si dhe themelimin e 18 instituteve kërkimore të sistemit të Ministrisë së Bujqësisë.

Duke hulumtuar ndër vite studime, ajo na jep fakte interesante të shekullit të kaluar, vlerëson shumë punën pasionante të brezave të shkencëtarëve dhe specialistëve, pa u futur në gamën e gjërë të emrave dhe jetëshkrimeve të tyre. Njëkohësisht bën analiza kritike të politikave të kërkimit bujqësor dhe shërbimit këshillimor, duke filluar nga vitet

1920 deri në zhvillimet e fundit dhe jep konsiderata për të ardhmen e këtyre shërbimeve. Në librin e saj paraqiten përpjekjet e brezave në fushën e informacionit bujqësor duke filluar nga botimet e përmasave kombëtare, si “Shqipëria më 1927” e Selenicës dhe disertacioni i Dr. Zavalanit, i 1938, mbi “Situatën e Bujqësisë në Shqipëri” dhe deri tek Revista modeste e vitit 1921 “Bagëti e Bujqësi”.

Ky libër është një një thirrje, për të vlerësuar arritjet e së kaluarës, për të mësuar nga gabimet dhe për ruajtjen e njohurive institucionale, të

cilat shpesh rrezikojnë të humbasin, në ciklet politike dhe ndryshimet administrative.

Promovimi i këtij botimi



ishte një ngjarje e veçantë, ku morën pjesë kërkues, agronomë terreni, pedagogë, studentë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe fondacio-



neve. Personalitete të njohura të fushës së bujqësisë si dhe

historianë të njohur, vlerësuan librin si një referencë për brezat e sotëm dhe të ardhshëm të studiuesve, pedagogëve dhe politikbërësve.

Prof. Dr. Tatjana Dishnica ka lënë gjurmë të thella në fushën e bujqësisë shqiptare – si në terren, ashtu edhe në institucione. Libri i saj nuk

është vetëm një kujtesë historike, por edhe një “testament” i përkushtimit të saj ndaj dijes, shërbimit publik dhe pasionit për zhvillimin e qëndrueshëm

të bujqësisë shqiptare. **E. Xh.**

Shoqata e blegtorëve kundër kompensimit të TVSH-së 10% me autofaturë, por me faturim direkt

Shoqatat e bizneseve pr ezantuan kërkesat e tyre në dëgjuesën për projektligjet e paketës fiskale në Komisionin e Financave dhe Ekonomisë.

Kryetari i Shoqatës së Blegtorëve të Qumështit Gentian Lalaj kërkoj që kompensimi i TVSH-së 10% të mos bëhet nëpërmjet autofaturave të lëshuara nga përpunuesi, por me faturim direkt nga fermeri. Për shoqatën e blegtorëve autofatura e lëshuar prej përpunuesve është abuzive.

“Shitja e qumështit deri në 70% ndodh pa fature, pasi autofatura është një abuzim ndaj fermerit që përpunuesi e pret, kur e ku i duhet, sa i duhet me çmimin që i duhet, për të rregulluar bilancin e tij mujor apo vjetor apo për të qenë në rregull me veten e vet.

Nuk e kuptojmë pse nuk rregullohet, domethënë, pse nuk ka një kontroll nga qeveria që të ketë një faturim direkt të mallit nga qumështi. Le të themi kemi një fermë me nëntë lopë, prodhojnë 30 litra për lopë, 270 litra qumësht. Nuk e kuptoj pse nuk ky fermer ose kjo fermë nuk duhet ta faturojë

vetë, prodhimin e saj. baxhot e vogla punojnë deri në kufirin 10 mln lekë për të mos kaluar në TVSH, dhe kjo është arsyeja pse blegtorit shqiptar i merret qumështi me 45 deri 50 lekë. Kjo do të sjellë që nëse 100 mijë litra, fermeri do të faturohet vetëm 50 mijë.

Kompensimi 10% të jepet kundrejt faturës që lëshon vetë fermeri”.

Shoqata e Blegtorëve gjithashtu kërkoj edhe barazimin e TVSH-së për blerjet dhe shitjet e mallrave me TVSH të fermerit, si dhe zbatimin e skemës së kompesimit mbështetur mbi litra qumësht të prodhuar.

“Ne kërkojmë një barazim të TVSH-së sa të doni vendoseni ju, 20 me 20%, 5 me 5% ose 10 me 10%. Ne që shesim qumësht, por dhe si blerës si ferma që jemi, ne sot gjendemi në realitetin që fermerët shqiptarë që prodhojnë misër, prodhojnë elb, prodhojnë jonxhë, nuk na i shesim dot produktet e tyre, sepse edhe ne nuk mund t’i blejmë dot. Nuk i blejmë dot për arsye se ne nuk na njihen TVSH-ja në sistem i blerjeve

që mund të bëjmë. Sepse nëse po bëjmë një krahasim orë, nëse 1 kg misër është 25 lekë, për grumbulluesi ta sjell tek ferma 30 lekë, sepse ta jep me TVSH. Neve nuk mund t’ia paguajmë 30 lekë, sepse ajo 5 lekë do ta na transformojë në pagesë në fundin e muajit për kundrejt shtetit.

Por nëse shteti do të na njihte fiskalisht fermerin e vogël, që mund të njihte TVSH-në, në faturën që ai do të presë për kile, misër, kile, elb, kile, jonxhë apo çdo produkt që ai mund të prodhojë, neve do të ishim të gatshëm të blinim të gjitha produktet që ne na rrethon, nëse secili prej nesh në fermat tona.

Kemi sugjeruar gjithashtu subvencion lekë për liter për prodhuesit e qumështit, të paktën për 2 vjet. Kjo do të sillte formalizim të tregut deri 95%. Kjo do të sillte deklaram të prodhimeve bujqësorë. Nuk do të kishte abuzim më nga përpunuesit. Por nga Ministria e Bujqësisë është shpjeguar që kjo skemë nuk pranohet nga Bashkimi European”.

“Monitor”

25-vjetori i Kontabilistëve, Fino: BMP kontribuoi në rritjen dhe forcimin e profesionit

Instituti i Kontabilistëve të Miratuar (IKM) kremtoi 25-vjetorin e themelimit, duke mbledhur në event personalitete të ekonomisë dhe politikës, të cilët shprehën vlerësimin për rolin dhe rëndësinë e profesionit të kontabilistit.



Presidenti i Institutit të Kontabilistëve, Sotiraq Dhamo, u shpreh se gjatë këtyre viteve, IKM ka dhënë një kontribut të rëndësishëm për evoluimin e profesionit të kontabilistit.

Kryetari i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, Dritan Fino deklaroi se profesioni i

kontabilistit përballet me sfida të reja, që kërkojnë vizion, investim dhe përshtatje të shpejtë.

“Përdorimi i teknologjive të reja, automatizimi dhe digitalizimi i proceseve; nevoja për aftësi të reja analitike dhe digjitale, si dhe konkurrenca

ka dhënë inpakt në forcimin e rolit mbikëqyrës të BMP dhe një standard më të strukturuar në funksionet dhe shërbimet e kontabilitetit, siç është “Forensic” (kontabiliteti hetimor).

Ish-ministri i financave Arben Malaj, e cilësoi të rëndësishëm rolin e kontabilistit, në epokën e inteligjencës artificiale.

Ndërsa kryetarja e komisionit të Ekonomisë, Milva Ekonomi, teksa vlerësoi rolin e kontabilistëve, kërkoj që ata të japin ndihmesën e tyre në luftën kundër informalitetit.

Si anëtar i organizatave të rëndësishme financiare në botë, IKM, ka luajtur një rol të rëndësishëm përgjatë këtyre 25 viteve për transformimin e profesionit të kontabilistit.

Me përvojën e fituar dhe reputacionin e konsoliduar, IKM mbetet i përkushtuar ndaj inovacionit dhe transformimit digjital dhe përmirësimit të shërbimeve profesionale. Puna e kontabilistëve synon rritjen e ndikimit të këtij profesioni në zhvillimin ekonomik të vendit.

KËNDI I EKSPERTIT

Pamja e qiellit gjatë muajit dhjetor 2025
Më 5 dhjetor - Hëna e Plotë, Superhëna. Hëna do të jetë e vendosur në anën e kundërt të

Parashikimi i motit për muajin dhjetor 2025 në Tiranë (Zona bregdetare)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Përshkrimi i shkurtër i motit	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi				
						D	N	D	N			
1	10	15	7/15/2015	4.3	2.5	13	7	JJL	JL	1	Shi në mëngjes, pastaj vranësirë	
2	9	16	5/16/2016	9.4	1	11	13	JL	J	1	Kryesisht vranësirë	
3	9	16	7/16/2016	6.2	4	11	11	JJL	J	1	Periudhë me shira	
4	10	17	6/16/2016	17.7	9.5	13	17	J	JJP	1	Vranësirë me ndonjë shi të rastit	
5	8	17	9/18/2018	0	0	4	2	LJL	L	1	Kryesisht me re	
6	7	16	7/17/2017	0	0	6	4	LJL	LJL	1	Interval me re dhe kohë me diell	
7	8	17	8/17/2017	0	0	9	11	LJL	JJL	1	Vranësirë e konsiderueshme	
8	9	17	7/16/2016	0.7	2.5	11	13	JL	JJL	1	Vranësirë;një shi me pika në mëngjes i ndjekur nga një shi i imët pasdite	
9	9	16	4/15/2015	7.2	5	11	15	JL	JJL	0	Periudhë me shira	
10	9	16	7/15/2015	11.6	8.5	13	9	JJL	JJL	1	Kryesisht me vranësirë me shi të rastit	
11	9	16	7/17/2016	1.1	2.5	6	6	JJL	J	1	Disa shira në mëngjes pastaj kohë me re dhe diell	
12	9	15	9/14/2014	16.3	8.5	11	2	JJP	VVL	0	Shi	
13	8	16	8/16/2016	0	0	7	4	JJL	VL	1	Kryesisht me re	
14	8	16	7/17/2016	0	0	7	4	L	LJL	1	Një përzierje e diellit dhe re	
15	8	17	6/17/2017	0	0	9	11	JL	JJL	1	Periudhë me re dhe kohë me diell	
16	8	15	8/16/2016	17.4	7	7	4	JJP	VL	1	Kryesisht vranësirë me shira e stuhi që do përhapen më shumë	
17	6	16	6/17/2015	0	0	9	4	VVL	LVL	2	Diell dhe pak re	
18	5	14	6/16/2014	0	0	6	4	JL	LJL	2	Pjesërisht me diell	
19	5	14	5/15/2015	1.3	2	7	4	L	L	1	Vranësirë	
20	7	15	6/17/2016	0	0	4	4	LJL	JL	1	Kohë me re dhe diell	
21	8	15	2/12/2012	18.2	8.5	15	17	JL	JJL	0	Vranësirë me disa shira, pastaj një shi i qëndrueshëm	
22	3	14	(-1)-12-10	0	0	22	19	LVL	L	2	Kryesisht me diell	
23	4	13	3/15/2013	0	0	9	7	LVL	LVL	2	Kryesisht me diell	
24	4	13	1/16/2014	0.4	1	4	9	VVP	JP	2	Plot me diell	
25	4	13	(-3)-13-13	2.8	4.5	9	13	PJP	VVL	1	Vranësirë e madhe me ndonjë shi të vogël	
26	3	13	(-4)-11-10	0	0	20	19	VL	VL	2	Kohë me re dhe diell	
27	2	13	(-7)-10-10	3.2 0.2D	5 0.5	22	30	VVL	VVL	1	Vranësirë e madhe; një shi me pika në mëngjes i ndjekur nga një shi i vogël pasdite	
28	2	13	(-5)-8-8	0.6	2	32	28	VVL	VL	1	Vranësirë e madhe; një shi me pika në mëngjes i ndjekur nga një shi i vogël pasdite	
29	3	13	(-1)-10-9	0	0	22	19	VL	VL	2	Pjesërisht me diell	
30	3	13	0-12-11	0	0	13	13	V	V	2	Kryesisht me diell	
31	3	13	(-3)-12-11	0	0	15	20	VVL	VL	2	Kohë me re dhe diell	

Tokës me Diellin dhe faqja e saj do të jetë plotësisht e ndriçuar. Kjo fazë do të ndodhë në orën 00:14 UTC. Kjo hënë e plotë njihej nga fiset e hershme vendase amerikane si Hëna e Ftohtë, sepse kjo është koha e vitit kur ajri i ftohtë i dimrit vendoset dhe netët bëhen të gjata dhe të errëta. Kjo hënë është njohur gjithashtu si Hëna e Netëve të Gjata dhe Hëna Para Pashkëve. Kjo është gjithashtu e fundit nga tre superhëna për vitin 2025. Hëna do të jetë afër afrimit të saj më të afërt me Tokën dhe mund të duket pak më e madhe dhe më e ndritshme se zakonisht.

Më 7 Dhjetor - Mërkuri në Zgjatimin më të madh perëndimor. Planeti Mërkuri arrin zgjatimin më të madh perëndimor prej 20.7 gradësh nga Dielli. Kjo është koha më e mirë për të parë Mërkurin pasi ai do të jetë në pikën e tij më të lartë mbi horizont në qiellin e mëngjesit. Kërkoni planetin ulët në qiellin lindor pak para lindjes së diellit.

Më 13, 14 dhjetor - Shiu i Meteorëve Geminids. Geminids është mbreti i shirave të meteorëve. Shumë veta e konsiderojnë si shiun më të mirë në qiell, duke prodhuar deri në 120 meteorë shumëngjyrësh në orë në kulmin e tij. Prodhohet nga mbeturinat e lëna pas nga një asteroid i njohur si 3200 Phaethon, i cili u zbulua në vitin 1982. Shiu ndodh çdo vit nga 7 deri në 17 dhjetor. Ai do të arrijë kulmin këtë vit në natën e datës 13 dhe mëngjesin e datës 14 dhjetor. Hëna e çerekut të dytë do të bllokojë disa nga meteorët më

Treguesit mesatarë klimatikë gjatë muajit dhjetor 2025

Treguesit	Tiranë	Korçë	Vlorë	Shkodër	Dibër	Gjirokastrë
Temperatura e ajrit						
Mesatare (°C)	9	3	12	9	1	9
Maksimale (°C)	12	6	13	12	5	12
Minimale (°C)	7	1	10	6	-2	6
Më e larta gjatë viteve (°C)	18 (2015)	13 (2010)	19 (2014)	18 (2025)	14 (2015)	18 (2015)
Më e ulta gjatë viteve (°C)	-6 (20210)	-20 (2010)	0 (2014)	-7 (2014)	-25 (2010)	-6 (2010)
Numuri i ditëve me Temperatnë + 30°C (Ditë dhe %)	0	0	0	0	0	0
Numuri i ditëve me Temperat në + 18°C (Ditë dhe %)	0	0	1 (3)	0	0	0
Numuri i ditëve me Temperat nën-0°C (Ditë dhe %)	2 (6)	15 (480)	0	2 (6)	23 (74)	3 (10)
Era						
Shpejtësia e erës (Km/Orë)	13	11	21	12	11	12
Temperatura e erës (°C)	5	-1	8	4	-5	4
Reshjet (Shiu)						
Shi (mm)	215	137	234	309	198	254
Numuri i ditëve me shi (Ditë dhe %)	9 (28)	7 (21)	9 (28)	9 (29)	9 (280)	9 (29)
Sasia rekord e shiut gjatë një dite (mm dhe vit)	143.6 (2017)	68.6 (2020)	119.2 (2017)	105 (2019)	97.1 (2017)	259.6 (20170)
Reshje dëbore cm	1.1	300.3	1.2	7.6	323.5	3.7
Lagështia e ajrit (%)	78	89	75	80	88	84
Shikueshmëria (Km)	9.36	7.85	9.36	9.01	8.12	9.09
Mbulimi i qiellit me re (%)	32	45	32	37	43	38
UV index	3	2	4	3	2	3
Orë me diell neDitë	8	8	8	8	8	8
Gjatësia e ditës (Orë)	9:12	9:17	9:18	9:08	9:11	9:20
Vlerësimi i muajit	Keq	Shumë keq	Mesatare	Keq	Shumë keq	Keq



